



## ***DEBATI KOSOVAR MBI ÇËSHTJET EUROPIANE***

*Përmbledhje e tetë analizave në fushën e arsimit, sundimit të ligjit  
dhe ekonomisë*

**Prishtinë**

**Dhjetor, 2009**

## **DEBATI KOSOVAR MBI ÇËSHTJET EUROPIANE**

*Përmbledhje e tetë analizave në fushën e arsimit, sundimit të ligjit  
dhe ekonomisë*

*Ky projekt dhe ky publikim janë përkrahur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës Çeke në kuadër të programit për promovimin e Tranzicionit nga Republika Çeke dhe nga National Endowment for Democracy (NED).*

### **Ekipi i projektit dhe mirënjohje:**

Venera Hajrullahu – KCSF

Fatmir Curri – KCSF

Eliška Sláviková – EUROPEUM

David Král – EUROPEUM

Vladimír Bartovic – EUROPEUM

Petr Pajas – PASOS

Ivo Šlosarčík – Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Charlsit, Pragë

Luboš Lacina – Universiteti Mendel, Brno

### **Autorët dhe kontribuesit e analizave:**

Melinda Mula – Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

Arjeta Emra – Këshilli Britanik Kosovë

Valentina Qarri – SPARK

Ramadan Ilazi – Lëvizja FOL

Merita Mustafa & Besnik Ramadanaj – Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Alban Zogaj – Instituti RIINVEST

Mimoza Kusari Lila – Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë

Flamur Keqa – Oda Ekonomike e Kosovës (OEK)

### **Organizatave Kosovare të kyqura në projekt:**

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

Këshilli Britanik Kosovë

SPARK

Lëvizja FOL

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Instituti RIINVEST

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (AMCHAM)

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK)

### **Lektorimi i gjuhës angleze**

Shaun Hughes

### **Dizajni dhe Shtypi**

Rezniqi - Adnan R. Co

*Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile ( KCSF )*

+ 381 38 248 636

[www.kcsfoundation.org](http://www.kcsfoundation.org)

[office@kcsfoundation.org](mailto:office@kcsfoundation.org)

*Këto analiza janë punuar nga ekspertët Kosovar në kuadër të projektit “Debati Kosovar mbi Çështjet Europiane”. Përshkrimet, analizat, dhe rekomandimet e prezentuara paraqesin pikëpamjet individuale të autorëve dhe jo gjithmonë paraqesin qëndrimet zyrtare të Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) apo të organizatave ku punojnë apo i përfaqësojnë.*

## Përmbajtja

PËRRETH PROJEKTIT: DEBATI KOSOVAR MBI ÇËSHTJET EUROPIANE .....	5
BIOGRAFITË E AUTORËVE: .....	6
1. ARSIMI .....	8
1.1 FINANCIMI I ZHVILLIMIT PROFESSIONAL TË MËSIMDHËNËSVE: NEVOJË URGJENTE PËR NJË STRATEGJI.....	8
1.2 A ËSHTË ARSIMI DHE TRAJNIMI PROFESIONAL NË KOSOVË I DIZAJNUAR PËR T’I PËRMBUSHUR NEVOJAT E TREGUT? .....	17
1.3 NJOHJA E KREDIVE NGA KURSET NË NJËSITË AKADEMIKE JO-AMË NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS.....	29
2. SUNDIMI I LIGJIT .....	32
2.1 LUFTIMI I KORRUPCIONIT: SI TË BËHET MË EFEKTIV AGJENCIONI ANTI-KORRUPSION? 32	
2.2 FINANCIMI I PARTIVE POLITIKE: NEVOJA PËR NJË LIGJ TË VETËM .....	38
3. EKONOMIA .....	44
3.1 A JEMI TË GATSHËM T’I PRIVATIZOJMË NDËRMARRJET PUBLIKE? .....	44
3.2 ZBATIMI I CEFTA-SË: REALITET APO VETËM DËSHIRË E BUKUR? .....	50
3.3 SI TË RRIET KAPACITETI I KOSOVËS PËR EKSPORT .....	56

# Përreth Projektit: Debat i Kosovës mbi Çështjet Europiane

Projekti është inicuar dhe zbatuar nga Fondacioni Kosovës për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Instituti për politika Europiane EUROPEUM ( Republika Çeke)

## **OBJEKTIVAT:**

- Të krijohet një kornizë për debat të strukturuar të ekspertëve që ka të bëjë me problemet urgjente të shoqërisë Kosovare, të cilat janë kyçe për përafrimin e Kosovës me BE-në, ndërtimi i një platforme për formulimin e rekomandimeve në fushat kyçe për shoqërinë Kosovare (të cilat në të njëjtën kohë paraqesin standardet Europiane)
- Ngritja e kapaciteteve për: të udhëhequr debat të strukturuar, identifikimin e problemeve kyçe në shoqëri dhe gjetja e zgjidhjeve për to përmes asistencës nga ekspertiza Çeke, mundësimin e transferit të njohurive dhe praktikave më të mira nga Republika Çeke në Kosovë
- Fuqizimi i debatit lokal në Kosovë në çështjet e ngrohta të cilat do të fuqizojnë pronësinë lokale të ideve dhe të zgjidhjeve,
- Avokimi i zgjidhjeve të propozuara me qëllim të përfshirjes së rekomandimeve të ekspertëve dhe të debateve publike tek vendim marrësit.

## **KOMPONENTET E PROJEKTIT:**

- Trajnimi strategjik dhe ai mbi politikën
- Takimet e grupeve punuese në temat individuale dhe shkrimi i analizave
- Diskutimet publike dhe seminarët
- Avokimi drejt vendim marrësve dhe autoriteteve publike

## **FUSHAT E ADRESUARA NGA ANA E PROJEKTIT:**

- ARSIMI – Aftësimi dhe trajnimi profesional, financimi i zhvillimit profesional të mësimeve, njohja e kredive ECTS nga kurset akademike brenda UP-së.
- SUNDIMI I LIGJIT – Agjencia Anti-Korrupsion; Financimi i Partive Politike.
- EKONOMIA – Bashkëpunimi Rajonal – Marrëveshja e Tregtisë së Lirë - CEFTA, Privatizimi i Ndërnarrjeve Publike në Kosovë, kapacitetet eksportuese dhe konkurrenca.

## **BIOGRAFITË E AUTORËVE:**

**Melinda MULA** që nga viti 1994 punon si asistente në Departamentin e Matematikës në FSHMN. Që nga viti 2000 ajo është aktive si koordinatore e programit në Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC). Ajo ka ligjëruar lëndën e matematikës në shkollën fillore në Gjakovë ndërmjet viteve 1992 dhe 1994. Melinda është e diplomuar në Maj të vitit 1993 në matematikë nga Fakulteti i Matematikës dhe Shkencave Natyrore, Universiteti i Prishtinës derisa ka magjistruar në Janar të vitit 2009. Ajo ka të regjistruar studimet e doktoratës që nga Marsi i vitit 2009.

**Arjeta EMRA** është drejtore e Këshillit Britanik në Kosovë me përvojë në çështjet e arsimit dhe reformave. Përvoja paraprake profesionale përfshin çështjet e të drejtave të njeriut, çështjet e zhvillimit dhe në 10 vitet e fundit (me Këshillin Britanik) në zhvillimin e strategjisë për monitorim dhe vlerësim për Kosovën. Për momentin ajo menaxhon një ekip prej 10 persona dhe udhëheq në fushën e arsimit të lartë për KB në Kosovë. Ajo ka kaluar 9 muaj si këshilltare politike për Kryeministrin e Kosovës (Dhjetor 2004 – Shtator 2005) dhe për momentin është pjesë e ekipit udhëheqës për Europën Jug-lindore dhe përkrah objektivat e përgjithshme të Këshillit Britanik në rajon dhe më gjërë.

**Valentina QARRI** është udhëheqëse e zyrës SPARK në Kosovë dhe punon në zhvillimin e arsimit të lartë dhe atë ekonomik në Kosovë. Ajo ka magjistruar në menaxhimin e shërbimeve nga Instituti Teknologjik i Rochesterit (RIT). Ajo është e diplomuar në filozofi nga Universiteti i Prishtinës. Valentina ka punuar një vit në zyrën për marrëdhënie ndërkombëtare të Universitetit të Prishtinës. Ajo ka menaxhuar dhe udhëhequr disa programe të arsimit për vite me radhë si: Universiteti Veror Ndërkombtar në Prishtinë (2001 -2004), Sektori Privat Rajonal (2002 – 2005), Business Start up Center Kosova ( 2005-2006) dhe të tjera. Që nga viti 2008 ajo është koordinatore e Kolegjit Ndërkombtar për Biznes në Mitrovicë i cili është nën themelimin e sipër.

**Ramadan ILAZI** është bashkëthemelues i Lëvizjes FOL në fillim të vitit 2008 dhe që nga ajo kohë është drejtor ekzekutiv i Lëvizjes FOL. Ai është në përfundim të studimeve në Marrëdhënie Ndërkombtare dhe Administratë Publike në UP . Ai ka marrë pjesë në Shkollën Politike të Prishtinës (PIPS) dhe në Institutin për Demokraci dhe Diversitet nga New School University, New York.

**Merita MUSTAFA** që nga dhjetori i vitit 2008 është duke udhëhequr programin për Transparencë dhe Anti-korrupsion në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI). Në të kaluarën ajo ka punuar si zyrtare e projektit në Business start - up Center Kosova. Përvoja e saj përfshin pozitat si në sektorin jo qeveritar po ashtu edhe atë privat, duke përfshirë biznesin personal. Merita ka studjuar programin për Menaxhmnet në Institutin IPKO në Prishtinë.

**Besnik RAMADANAJ** që nga viti 2009 punon për Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) si menaxher për marrëdhënie me publikun. Në vitet 2004-2009 ka punuar si gazetar në disa media të shtypura dhe ato elektronike. Ai ka diplomuar në vitin 2004 në shkenca politike dhe administratë publike në fakultetin e filozofisë, Universiteti i Prishtinës.

**Alban ZOGAJ** është ligjërues në departamentin e ekonomisë në Universitetin AAB – RIINVEST si dhe drejtor hulumtues në Institutin RIINVEST, një nga qendrat më të mëdha të hulumtimit në Kosovë. Interesat e tij për studim përfshijnë: zhvillimin ekonomik, politikat industrial për vendet në zhvillim, procesi i privatizimit në vendet e tranzicionit, zhvillimi arsimor dhe politikat fiskale. Ai është i diplomuar në Menaxhment dhe Informatikë në vitin 2004 nga Universiteti i Prishtinës dhe ka magjistruar në Ekonomi dhe Analiza të Biznesit në vitin 2006 nga Universiteti Staffordshire në Mbretërinë e Bashkuar. Për momentin ai është duke përgatitur për studimet e doktoratës.

**Mimoza KUSARI LILA** ndërmjet viteve 2006 dhe 2009 ka shërbyer si drejtore ekzekutive për Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë. Mes viteve 2003-2004 ajo ka punuar si zëdhënëse e qeverisë së Kosovës dhe pastaj ka qenë edhe drejtore e departamentit për energji në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave. Në zgjedhjet lokale të nëntorit 2009 Mimoza u kandidua për kryetare të qytetit të Gjakovës. Mimoza është e diplomuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik në fushën e menaxhimit dhe sistemeve informatike. Mimoza ka mbaruar magjistraturën për e-biznes në Institutin Ekonomik, Universiteti i Kolorados dhe Duquesne në Pittsburg, Pensilvani. Pas kthimit në Kosovë në vitin 2001, Mimoza ka punuar për Bankën Botërore dhe projektin e USAID për përkrahjen e biznesit Kosovar derisa më vonë ajo ka qenë menaxhere e projektit për Universitetin Amerikan në Kosovë deri në themelin e tij.

**Flamur KEQA** është drejtor për analiza ekonomike në Odën Ekonomike të Kosovës (OEK) dhe anëtar i bordit të drejtorëve në Korporatën Energjetike të Kosovës. Përvoja e tij profesionale përfshin ekperiencë nga fusha e sektorit financiar për 20 vite duke punuar në pozita menaxheriale si regullator bankar dhe në banka komerciale duke dhënë kontribut për ndërtimin e sistemit bankar në Kosovë. Ai ka punuar si konsulent për organizata ndërkombtare si: BB, SDC, SIDA dhe është anëtar i disa grupeve punuese të qeverisë për legjislacion ekonomik, anëtar i BSC-së, anëtar i Komitetit Profesional për Standarde dhe anëtar i nën komitetit për CEFTA.

# 1. ARSIMI

## 1.1 *Financimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve: Nevojë urgjente për një strategji*

*Autore: Melinda Mula, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)*

*“Kur planifikoni për një vit, mbillni misër.  
Kur planifikoni për një dekadë, mbillni drunjë.  
Kur planifikoni për një jetë, shkolloni dhe arsimoni njerëzit.”*

*Guanzi, 645 p.e.s.*

### **Hyrja**

Hulumtimet në mënyrë të vazhdueshme tregojnë se investimi në arsim është një burim i rëndësishëm i rritjes së qëndrueshme ekonomike të një vendi. Një arsim cilësor i rritë gjasat për punësueshmëri më të madhe të gjeneratave të reja, e me këtë dhe standard më të mirë të jetës. Në Kosovë, e cila në njërin anë ka rritjen më të vogël ekonomike në rajon 3,9 % dhe shkallën më të lartë të papunësisë 43,6 %, ndërsa në anën tjetër shkallën më të lartë të natalitetit 1,6 % dhe mbi 33 % të popullsisë nën moshën 15 vjeçare, investimi në arsimin cilësor duhet të merret në konsiderim në mënyrë serioze dhe të përdoret si një faktor për ndryshimin e gjendjes ekzistuese.

Dy kabinetet e fundit qeveritare të Kosovës e kanë përfshirë arsimin si njërin ndër prioritetet e tyre qeverisëse. Kjo solli rritjen e shkallës së investimeve kapitale në arsim, nga 9.6 mil. EUR në vitin 2006 në 35,4 mil. EUR në vitin 2009, si dhe rritjen e shpenzimeve publike për arsimin nga 104.2 mil. EUR në vitin 2006 në 151.4 mil. EUR në vitin 2009. Me gjithë rritjen, shpenzimet publike për arsimin nuk tejkalojnë 3.8% e GDP, sasi kjo e pamjaftueshme për të realizuar një skenar reformues dhe për të implementuar dokumentet strategjike për arsimin.

Është inkurajues fakti se Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT) ka shpallur vitin 2009 si “Vit të cilësisë në arsim”. Meqë zhvillimi profesional i mësimdhënësve është njëri ndër faktorët e rëndësishëm për sigurimin e cilësisë, MASHT në Janar të vitit 2009 themeloi Këshillin Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KShLM) për të punuar në hartimin e dokumenteve, të cilat do të përcaktojnë kriteret dhe procedurat për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Mirëpo, për momentin ekziston një paqartësi rreth mënyrës së financimit të zhvillimit profesional.

Deri në vitin 2008, MAShT kishte përgjegjësi për zhvillimin profesional, por me aprovimin e Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës kjo përgjegjësi i delegohet komunave. Bartja e përgjegjësisë është shoqëruar me probleme, sepse komunat



nuk kanë poseduar mekanizma, burime njerëzore dhe materiale për të përballuar këtë përgjegjësi shtesë.

Kjo analizë do të fokusohet në identifikimin e mënyrave të ndryshme të financimit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, si dhe në propozimin e alternativave për krijimin e mekanizmave brenda komunës për të funksionalizuar këtë proces. Analiza mund të shërbejë si një bazë e mirë për nxjerrjen nga ana e MASHT të akteve normative që rregullojnë financimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

### **Klima për zhvillim profesional**

Njëra ndër ndërhyrjet e para të UNMIK-ut ishte themelimi i Departamentit të Arsimit dhe Shkencës (DASH). Mungesa e praktikës profesionale në institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit, si dhe izolimi për një kohë të gjatë i sistemit të arsimit nga ndikimet e zhvillimeve pozitive në botë, bëri që DASH të identifikojë nevojën për zhvillim profesional të personelit arsimor si një prioritet, si dhe të mobilizojë donatorë dhe agjensione ndërkombëtare për ta realizuar një gjë të tillë.

Duke iu falënderuar përkrahjes financiare të shumë donatorëve ndërkombëtarë (UNICEF, Save the Children, Bankës Botërore, CRS, CIDA) si dhe përkushtimit të OJQ vendore (KEC, KEDP) një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve arriti të vijojë programe të ndryshme për zhvillimin profesional. Me themelimin e MASHT në vitin 2002, të gjitha këto institucione filluan bashkëpunimin me ministrinë duke i harmonizuar projektet e tyre me prioritetet e MASHT dhe me kërkesat e mësimdhënësve për zhvillim profesional.

Gjatë periudhës 2002-2008 MASHT kishte në dispozicion 200 mijë euro/vit për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Nëse marrim parasysh faktin se në Kosovë ka 25 mijë mësimdhënës, rrjedh se MASHT ka disponuar 8 Euro/vit për një mësimdhënës. Këtë situatë të vështirë e ka rënduar edhe më shumë mungesa e iniciativave nga ana e MASHT për bashkëpunim të mirëfilltë me ofertues të trajnimeve të financuar nga burime të jashtme, DKA dhe komunitetin. Procedurat e komplikuara financiare dhe të prokurimit e kanë penguar MASHT që të futet lehtësisht në marrëdhënie kontraktuale me ofertuesit e programeve të trajnimit. Mungesa e bashkëpunimit me DKA ka bërë që të mos shqyrtohen mundësitë e bashkëfinancimit të trajnimeve përmes shfrytëzimit të të hyrave komunale. Po ashtu, MASHT nuk e ka shqyrtuar fare mundësinë e kontributit që mund të ofrojë komuniteti dhe bizneset. Së fundi por jo më pak të rëndësishme, mungesa e akreditimit të programeve të trajnimit dhe mos përfshirja e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në sistemin e pagave ka ndikuar në varfërimin e ofertës dhe të iniciativave për zhvillim profesional, si dhe në kufizim të përkrahjes financiare nga donatorë të ndryshëm.

### **Sfidat që e përcjellin financimin e zhvillimit profesional**

Që nga viti 2000, zhvillimin profesional të personelit arsimor e kanë mbështetur financiarisht donatorë të fuqishëm ndërkombëtarë. Edhe pas themelimit të MASHT, disa donatorë vazhduan ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës. Me përfundimin e fazës

emergjente dhe konsolidimin e institucioneve vendore, shumë donatorë filluan të lënë Kosovën dhe kjo shkaktoi zvogëlimin e përkrahjes financiare për MASHT. Për momentin, në Kosovë ka mungesë të fondeve për zhvillim profesional të mësimit të mesëm, si dhe paqartësi lidhur me mënyrën e financimit të tij. Në njërin anë, MASHT ende menaxhon shumën e zotuar për trajnime, ndërsa në anën tjetër ligji këtë përgjegjësi ia delegon komunave.

Aprovimi i Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nga Parlamenti i Kosovës i gjeti të papërgatitura Drejtoratet Komunale të Arsimit (DKA). Ato u ballafaquan me problemin e mungesës së mekanizmave dhe kapaciteteve njerëzore për të përbërur përgjegjësitë e shtuara. Krijimi i një situate të tillë bëri që Banka Botërore të fillojë në vitin 2008 në komunitet e Gjilanit, Kaçanikut dhe Istogut një projekt pilot shumëvjeçar për formulën e re të financimit, e cila transferon fondet nga MASHT-i në komunitet dhe nga komunitet në shkollë. Përfunduesit e DKA të këtyre komunave kanë përmendur shumë probleme që janë krijuar në implementimin e pjesëve të caktuara të ligjit dhe veçanërisht në zhvillimin profesional të mësimit të mesëm. Mungesa e bashkëpunimit me MASHT për të organizuar trajnimet, ka bërë që këto DKA të mos kenë mundësi që më seriozisht të përfshihen në zhvillimin profesional të mësimit të mesëm. Një gjë e tillë është mjaft shqetësuese kur dihet se përvojat e këtyre komunave do të shpërndahen në komunitet e tjera duke filluar nga viti 2010.

Që nga viti 2010, qeveria do të alokojë 600 mijë euro/vit për zhvillimin profesional të mësimit të mesëm. Megjithatë kjo shumë është trefishi i shumës që ka menaxhuar MASHT, përsëri është e pamjaftueshme për të përmbushur nevojat për zhvillim profesional. Përveç fondeve të pamjaftueshme, situata bëhet dhe më problematike kur dihet se MASHT ende nuk ka një strategji për të kanalizuar fondet nga niveli qendror në atë lokal.

Për momentin, procesi i decentralizimit të sistemit të arsimit, delegimi i zhvillimit profesional të mësimit të mesëm në komunitet, si dhe politikat e reja për licencimin e mësimit të mesëm, hapin disa çështje të rëndësishme për financimin e zhvillimit profesional të mësimit të mesëm:

- Si do të financohet zhvillimi profesional i mësimit të mesëm në Kosovë?
- Cili do të jetë raporti i kontributit të pushtetit qendror me atë komunal?
- Si do të rregullohet bashkëfinancimi i projekteve me OJQ arsimore?
- Cili do të jetë roli i shkollave në sigurimin e zhvillimit profesional të stafit?
- Si do të sigurohet realizimi i së drejtës së mësimit të mesëm për pjesëmarrje në aktivitete të zhvillimit profesional? A do të ketë nevojë për bashkëfinancim?
- Si do të përfshihet kontributi i komunitetit të shkollës dhe biznesit?

Shtimi i kompetencave për zhvillim profesional brenda komunitet shoqërohet me nevojën për krijimin e mekanizmave për të menaxhuar këtë proces. Deri tash, DKA nuk ka pasur zyrtarë përgjegjës për zhvillimin profesional të mësimit të mesëm. Prandaj shtrohet edhe pyetja:

- Çfarë mekanizma do të krijohen brenda komunitet për të menaxhuar zhvillimin profesional të mësimit të mesëm?

Sigurimi i përgjigjeve në këto pyetje kërkon angazhimin e një grupi të ekspertëve. Gjithësesi, disa nga përgjigjet e mundshme do të jepen më poshtë.

### **Qasjet e mundshme për financim**

Në Kosovë nuk ka dokument zyrtar që përcakton mënyrën e financimit të zhvillimit profesional të personelit arsimor. Prandaj, është me interes që të propozohen alternativa për mënyrat e mundshme të financimit të një zhvillimit të tillë. Duke pasur parasysh procesin e decentralizimit dhe kompetencat që ligji iu ofron DKA-ve për zhvillim profesional, në këtë analizë janë identifikuar tri alternativa për të kanalizuar fondet nga niveli qendror në atë komunal. Alternativat janë të shoqëruara me arsyetimet për përparësitë dhe dobësitë, si dhe me këshillat për kujdes me rastin e zbatimit të tyre.

**Qasja e parë:** MASHT menaxhon me shumën për zhvillim profesional të mësimdhënësve.

MASHT kërkon të menaxhojë ende fondin për zhvillim profesional me arsyetimin se brenda komunave mungojnë kapacitetet për të planifikuar dhe menaxhuar këtë.

Përparësia:

- MASHT ka njohuri për programet e ndryshme të trajnimit dhe përvojë në organizimin e tyre.

Dobësitë:

- MASHT nuk do të ndihmonte komunat që të aftësohen për ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore,
- Është shumë vështirë prej nivelit qendror të identifikohen dhe adresohen nevojat e mësimdhënësve të komunave të ndryshme,
- Mospërfshirja e DKA në proces do të vështirësonte mundësinë e përfshirjes së OJQ të ndryshme dhe bizneseve që veprojnë në nivel komunal për të kontribuar në zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Ndonëse ka pak gjasa që të zgjidhet një kurs i tillë veprimi, nëse MASHT zgjedh këtë qasje, atëherë duhet të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes së DKA për të ndihmuar në organizimin e trajnimeve, sepse ato disponojnë me të dhënat e sakta për vijueshmërinë e mësimdhënësve në programe të trajnimit dhe janë më afër identifikimit të saktë të nevojave të mësimdhënësve për programe të caktuara.

**Qasja e dytë:** MASHT transferon fondin për zhvillim profesional të mësimdhënësve te DKA.

MASHT transferon fondin për zhvillim profesional te DKA sipas treguesve relevantë siç mund të jenë numri i shkollave, numri i mësimdhënësve dhe numri i nxënësve. Meqenëse madhësia e shkollave në Kosovë ndryshon dhe po ashtu ndryshon edhe numri i nxënësve prej vitit në vit, treguesi më i përshtatshëm duket të jetë ndarja e fondit në bazë të numrit të mësimdhënësve.

Përparësitë:

- Sigurohet forma më e lehtë për të transferuar buxhetin te DKA. Mjafton që të merret numri i mësimdhënësve nga regjistrat dhe automatikisht caktohet shuma që përfiton secila komunë.
- DKA do të dijnë paraprakisht shumën e caktuar që në fillim të vitit fiskal dhe do të mund të planifikojnë programet e trajnimit që do të organizohen brenda komunës dhe numrin e pjesëmarrësve në trajnime të ndryshme.

Dobësitë:

- Mungon faktori mobilizues për DKA. Ato mund të sillen në mënyrë joaktive në sigurimin e fondeve shtesë, duke mos kontribuar me fonde vetjake, apo duke mos bashkëpunuar me OJQ, biznesin privat dhe komunitetin.
- Në rast të ankesave për cilësinë e ultë të arsimit apo licencimin e një numri të vogël të mësimdhënësve nëpër kategori të ndryshme, DKA do të fshihej pas buxhetit të vogël të siguruar nga fondi qendror për zhvillim profesional.

MAShT duhet të kujdeset që në rast të zbatimit eventual të qasjes së këtillë, të kërkojë nga DKA transparencë dhe llogaridhënie të qartë.

**Qasja e tretë:** MAShT përcakton formulën e financimit duke u bazuar në lartësinë e kontributeve komunale.

Kjo qasje nënkupton bashkëfinancimin e zhvillimit profesional nga MAShT dhe DKA. Bashkëfinancimi do të përcaktohet përmes një formule e cila do të mbështetet në lartësinë e financimit nga komuna, por edhe duke marrë parasysh mundësitë objektive të secilës komunë. Kështu formula do të jetë e ndryshme për komunat me zhvillim të ndryshëm ekonomik. Një mundësi është që komunat të ndahen në katër kategori dhe për secilën kategori të përcaktohet raporti në mes të financimit nga niveli qendror dhe atij komunal. Një model i përcaktimit të raportit për financim mund të jetë:

- 3 : 1 për shtatë komunat e mëdha të Kosovës,
- 5 : 1 për komunat e vogla,
- 7 : 1 për komunat e reja dhe me të pazhvilluara ekonomikisht,
- Financim i plotë nga niveli qendror për komunat që nuk kanë mundësi participimi.

Përparësitë:

- Mënyra më efikase për sigurimin maksimal të fondeve për zhvillim profesional,
- Mobilizim i DKA për të siguruar sa më shumë burime financimi nga niveli komunal, në mënyrë që të shtojë financimin nga niveli qendror,
- Ofrim efikas i shërbimeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve,
- Mundësia që të aplikohet sistemi i “voucher” për të plotësuar nevojat për zhvillim profesional të mësimdhënësve brenda secilës shkollë. Kjo e ndihmon procesin e

decentralizimit të arsimit deri në nivel shkolle, siç është paraparë me nenit 8.4. të Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.

Në rast të zbatimit të kësaj qasje, është mirë që MASHT të disponojë me një fond të caktuar për të shpërblyer DKA që tregojnë performancë veçanërisht të mirë. Kjo nënkupton ato DKA të cilat kanë arritur që të përfshijnë institucionet e ndryshme, bizneset ose komunitetin në financimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve ose që kanë demonstruar iniciativa për organizim të trajnimeve me participim.

### **Mekanizmat për zbatim**

Nëse zbatohet qasja e parë, nuk ka nevojë për krijimin e mekanizmave për zhvillim profesional, sepse mekanizmat e tillë ekzistojnë brenda MASHT. Zbatimi i qasjes së dytë ose të tretë kërkon krijimin e mekanizmave për planifikim dhe menaxhim të zhvillimit profesional të mësimdhënësve brenda komunave. Opsione për krijimin e mekanizmave të tillë janë:

1. Emërimi i një bordi komunal dhe një zyrtari në DKA përgjegjës për zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Bordi komunal do të jetë me përbërje heterogjene, duke përfshirë zyrtarë të DKA, drejtorë shkollash, mësimdhënës me eksperiencë dhe përfaqësues i komunitetit. Disa nga detyrat e Bordit do të jenë:

- Miratimi i planit vjetor të punës të prezantuar nga zyrtari për zhvillim profesional,
- Përzgjedhja e programeve të trajnimit për vitin shkollor,
- Vendos për përfshirjen e shkollave dhe mësimdhënësve në trajnime, etj.

Zyrtari do të bëjë menaxhimin e përditshëm të procesit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Ai/ajo duhet të jetë përgjegjës për:

- hartimin dhe zbatimin e planit të punës,
- kërkimin e burimeve alternative të financimit,
- bashkëpunimin me ofrues të trajnimeve, institucione, këshilla të shkollave, e biznese,
- raportimin para bordit komunal, etj.

2. Emërimi i një zyrtari në DKA përgjegjës për zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Nëse komuna nuk ka mundësi të realizojë mekanizmat e identifikuar në opsionin 1, atëherë është mirë që të paktën të emërohet një zyrtar në DKA, i cili do të kryente detyrat e tij dhe do të merrte përsipër edhe obligimet e bordit të përshkruara në opsionin 1.

3. Emërimi i një zyrtari brenda komunës për zhvillimin profesional të shërbyesëve civil dhe shërbyesëve profesional.

Nëse komuna nuk mund të përballojë një zyrtar brenda DKA për të planifikuar dhe menaxhuar zhvillimin profesional të mësimdhënësve, atëherë këto detyra do të mund të mbuloheshin nga një zyrtar i caktuar në nivelin komunal, i cili është përgjegjës për

zhvillimin profesional të shërbyesëve civil dhe të shërbyesëve profesional brenda komunës.

## **Përfundim**

Decentralizimi në përgjithësi dhe decentralizimi në arsim në veçanti është në vijën e politikave qeveritare. Ky proces ka për qëllim të ofrojë shërbimet më afër qytetarëve, duke respektuar nevojat e tyre. Në pajtim me këtë, Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës transferon kompetencat për zhvillimin profesional të mësimit nga MASHT te DKA. Për të implementuar këtë ligj në pjesën e zhvillimit profesional të mësimit, duhet të përcaktohet mënyra e financimit të këtij zhvillimi.

Në kuadër të kësaj analize janë identifikuar tri qasje të mundshme të financimit të zhvillimit profesional të mësimit në kornizën e legjislativës së ri, si dhe tri opsione për krijimin e mekanizmave brenda komunës për të menaxhuar me zhvillimin profesional. Qasjet për financimin e zhvillimit profesional të mësimit janë:

- MASHT menaxhon me shumën për zhvillim profesional të mësimit,
- MASHT transferon fondin për zhvillim profesional të mësimit te DKA,
- MASHT përcakton formulën e financimit duke u bazuar në lartësinë e kontributeve komunale.

Qasja e parë në të vërtetë është vazhdimësi e mënyrës ekzistuese të financimit të zhvillimit profesional, e cila menaxhohet nga Departamenti i Trajnimeve në MASHT. Dy qasjet tjera kërkojnë krijimin e mekanizmave në nivelin komunal për të menaxhuar me procesin e zhvillimit profesional. Tri opsione për krijimin e mekanizmave brenda komunës janë:

- Emërimi i një bordi komunal dhe një zyrtari në DKA përgjegjës për zhvillimin profesional të mësimit,
- Emërimi i një zyrtari në DKA përgjegjës për zhvillimin profesional të mësimit,
- Emërimi i një zyrtari brenda komunës për zhvillimin profesional të shërbyesëve civil dhe shërbyesëve profesional.

## **Rekomandimet**

1. MASHT të përcaktojë formulën e financimit duke u bazuar në lartësinë e kontributeve komunale.

Qasja më efektive për sigurimin e fondeve maksimale për zhvillim profesional është përcaktimi i formulës së financimit duke u bazuar në lartësinë e kontributeve komunale. Në këtë rast, MASHT duhet të marrë në konsideratë lartësinë e financimit nga komuna, por edhe mundësitë objektive të secilës komunë. Meqenëse, komunat nuk kanë zhvillim të njëjtë ekonomik, MASHT duhet të ndajë komunat në disa kategori dhe të përcaktojë raportin e financimit të nivelit qendror dhe atij komunal për secilën kategori.

Bashkëfinancimi i zhvillimit profesional të mësimit të mesëm do të mobilizonte përfaqësuesit e DKA që të marrin me seriozitet zhvillimin profesional, sepse fitimi i fondeve qeveritare do të varej nga shkalla e participimit të DKA nga të hyrat komunale. Realizimi i një skenari të tillë do të mobilizonte DKA të shqyrtonin mundësitë për bashkëpunim më të ngushtë me OJQ arsimore, institucionet e ndryshme, bizneset dhe komunitetin shkollor. Participimi nga ana e DKA do t'i bënte ato më përgjegjëse për të ofruar shërbime më të mira për zhvillim profesional të mësimit të mesëm. Përfundimisht, delegimi i kompetencave në komunë do të mundësonte decentralizimin e mëtejshëm të këtij procesi deri në shkollë. Përparësia e një qasje të tillë është zbatimi i sistemit të “voucher”, si një formë demokratike e plotësimit të nevojave për zhvillim profesional të mësimit të mesëm brenda secilës shkollë.

2. Në secilën komunë të emërohet bordi komunal dhe zyrtari në DKA përgjegjës për zhvillimin profesional të mësimit të mesëm.

Emërimi i Bordit do të ndihmonte shumë procesin e zhvillimit profesional të mësimit të mesëm. Përbërja heterogjene e tij do të ndikonte në përzgjedhjen e trajnimeve në pajtim me nevojat dhe interesimet e mësimit të mesëm, si dhe do të ndihmonte përfshirjen e OJQ, institucioneve dhe bizneseve për të kontribuar në zhvillimin profesional të mësimit të mesëm. Emërimi i zyrtarit në DKA për zhvillim profesional është me interes të jashtëzakonshëm, sepse ai/ajo do të koordinojë përpjekjet e të gjitha palëve me interes dhe do të shërbejë si urë lidhëse në mes të MASHT, DKA, OJQ dhe mësimit të mesëm.

3. Të përgatitet një pako udhëzuese për zhvillimin profesional të mësimit të mesëm.

Për realizimin me sukses të procesit të zhvillimit profesional të mësimit të mesëm, përveç përcaktimit të mënyrës së financimit, MASHT duhet të kujdeset edhe për hartimin, publikimin dhe shpërndarjen e pakos udhëzuese, e cila do të ndihmonte DKA në këtë proces. Kjo pako duhet të përmbajë:

- Listën e ofertuesve të akredituar të trajnimeve me programet e trajnimit,
  - Katalogun e programeve të trajnimit,
  - Udhëzimin administrativ që përcakton kriteret dhe mënyrat e zhvillimit profesional të mësimit të mesëm,
  - Doracakun për vlerësimin e performancës së mësimit të mesëm,
  - Kriteret për përzgjedhjen e mësimit të mesëm në trajnim, etj
4. Të krijohet një fond i veçantë për plotësimin e nevojave emergjente për trajnime, ose për promovimin e risive në arsim.

MASHT duhet të ketë kujdes të ndajë një fond të caktuar për të intervenuar në raste emergjente ose për të pilotuar ndonjë projekt që sjell risi. Mund të ndodhë që rezultatet e testeve të klasave të 9-ta, të maturës ose ndonjë rrethanë tjetër të kërkojë që në ndonjë komunë të intervenohet me urgjencë me program të caktuar trajnime për të ndihmuar arritjen e standardeve të përcaktuara nga MASHT. Meqenëse arsimi është proces i cili reformohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sidomos në aspektin e zhvillimit profesional

të personeli arsimor, gjithmonë do të ketë kërkesa për të zbatuar ndonjë program trajnimi që sjellë risi ose bart me vete zhvillime pozitive të sistemeve të arsimit në rajon dhe më gjerë.

Të gjitha këto masa duhet të ndërmerren për të siguruar një zhvillim profesional sa më cilësor për personelin arsimor. Mësimdhënësit janë agjentët e ndryshimeve në shoqëri. Ata përgatisin gjeneratat e reja me njohuri dhe shkathtësi të nevojshme për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të një vendi. Për këtë arsye, investimi në zhvillimin profesional të mësimdhënësve është investimi më i mirë në të ardhmen e Kosovës.

**Burimet:**

Zyra e Statistikave në Kosovë, <http://www.ks-gov.net/esk/>

Buxheti i konsoliduar i Kosovës për vitin 2006, Korniza afatmesme e shpenzimeve 2009-2011, MEF, Qershor 2008.

Ligji mbi Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, No. 03/L-068, Maj 2008.



## **1.2 A është Arsimi dhe Trajnimi Profesional në Kosovë i dizajnuar për t'i përmbushur nevojat e tregut?**

*Autore:* Arjeta Emra, Këshilli Britanik Kosovë

### **Hyrje**

Në këtë punim shqyrtohen opsionet e politikave dhe zbrazëtirat në zhvillimin e arsimit profesional në Kosovë.

Kosova është njëri ndër vendet më të varfëra në Europë, por me popullësi shumë të re. Njerëzit në Kosovë shpeshherë i referohen popullsisë së re të Kosovës si 'pasuria e saj më e madhe'. Megjithatë, nëse i shohim aftësitë aktuale të rinisë do të ishte vështirë mos të themi që rinia është disavantazh!

Ekziston një kuptim i përgjithshëm që të gjitha ekonomitë përfitojnë nga rinia e vendit e cila është e informuar për mënyrën e funksionimit të industrisë dhe tregtisë dhe ka kulturë të nevojshme kreative në shoqëri ndërmarrëse për rritjen e mundësive të punësimit. Dy sfidat kryesore të Qeverisë së Kosovës dhe të shoqërisë në përgjithësi janë revitalizimi i ekonomisë kosovare dhe ofrimi i vendeve të punës për të papunësuarit.

Arsimi dhe trajnimi profesional (VET) në Kosovë po kalon nëpër proces të reformës. Ligji për trajnimin profesional u miratua në Prill të vitit 2006 për ta rregulluar sektorin formal. Njëri prej principeve themelore të draft-strategjisë për arsim të Qeverisë së Kosovës për periudhën 2007-2012 është sigurimi i arsimit cilësor dhe efikas me synim të harmonizimit me Bashkimin Europian. Reforma e arsimit dhe trajnimit profesional dhe teknik po zbatohet në mes të papunësisë tejet të madhe, posaçërisht në mesin e të rinjve. Punësimi i të rinjve prandaj është brenga kryesore e Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji (MASHT), Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS), dhe për punëdhënësit dhe shoqatat e punës. Deri më tani, sektori privat nuk ka qenë i përfshirë në masë të mjaftueshme në planifikimin dhe zbatimin e arsimit dhe trajnimit profesional dhe teknik në Kosovë dhe në përgjithësi nuk është i informuar mjaft për rolin që mund ta luajë në këtë fushë.

Aktualisht, është një projekt specifik i cili po e shqyrton çështjen e Arsimit dhe Trajnimit për Ndërmarrësi. Ky projekt ka të bëjë me zhvillimin e aftësive dhe cilësive personale në mënyrë që njerëzit e të gjitha moshave të fitojnë njohuri rreth mënyrës së funksionimit të ekonomisë dhe reagimit ndaj forcave të tregut. Projekti përmban qasje për zhvillimin e kreativitetit, zgjidhjen e problemeve, punën ekipore, ndërmarrjen e rreziqeve të kalkuluara, aftësitë e komunikimit, lidhshirësinë, vendimmarrjen, menaxhimin e kohës, marrjen e përgjegjësisë si dhe aftësi të tjera individuale që mund të çojnë në prospekte të përmirësuar për punësim. Arsimi dhe Trajnimi për Ndërmarrësi poashtu e identifikon rolin e ndërmarrësit në shoqëri dhe identifikon kërkesat e ndryshme të vetëpunësimit. Metodologjia për ofrimin e kësaj pakoje të arsimit dhe trajnimit është "*Të mësosh duke e bërë*". Kjo mund të jetë mënyrë e mirë për të shkuar përpara!

Bazat ligjore tashmë janë hedhur për ta bërë këtë projekt një tregim të suksesshëm. Megjithatë, do të varet se si do të veprojë Kosova ndaj të gjitha potencialeve që ofrohen. Nëse Kosova tregohet e suksesshme në ofrimin e aftësive të cilësisë së lartë për rininë e saj atëherë ajo ka korrur sukses duke i bërë ata 'pasuri të vërtetë' për të ardhmen.

## **Analiza e tregut të punës**

### *Trendet demografike*

Kosova ka popullsi në rritje e sipër e cila dominohet nga grupmoshat e reja. Meshkujt dhe femrat e reja të moshës nën-25 vjeçare përbëjnë 49% të popullsisë, prej të cilëve 19.1% janë mes moshës 15 dhe 24 vjeçare<sup>1</sup>. Kjo ndarje e re e moshave sigurisht do të çojnë në rritjen e mëturjes së fuqisë punëtore. Vlerësohet se në pesë vitet e ardhshme, rreth 200,000 të rinjë do ta arrijnë moshën për punë, dhe afro 110,000 prej tyre do të futen në tregun e punës<sup>2</sup>, derisa në periudhën e njëjtë rreth 60,000 persona do ta arrijnë moshën e pensionimit. Rritja e vazhdueshme e fitimit neto do ta rris edhe nevojën për vende të reja të punës.

### *Punësimi dhe papunësia*

Në Kosovë janë dy burime kryesore për statistikën e tregut të punës: Hulumtimi i Fuqisë Punëtore (HFP) i zhvilluar çdo vit nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK) që nga viti 2001, dhe të dhënat e regjistrimit të Shërbimeve për Punësim Publik (SHPP). Të dhënat që janë në dispozicion kanë disa kufizime. Së pari, mungesa e regjistrimit të popullsisë shtron pyetjen mbi besueshmërinë e ratës së mostrave prej më pak se 2 përqind të përdorur në HFP. Së dyti, HFP-të zakonisht zhvillohen në çereket e fundit të vitit, dhe nuk mund ta kapin në mënyrë adekuate punësimin sezonale gjatë muajve të verës. Së treti, regjistri i papunësisë së SHPP-së është i stërmbytur me një numër të madh njerëzish që nuk kërkojnë punë në mënyrë aktive, apo që punojnë në sektorin joformal, përderisa ka shumë të papunësuar që nuk janë regjistruar në SHPP. Nevojitet përkrahje e mëturjes në mënyrë që SHPP dhe ESK të mund t'i adresojnë këto kufizime dhe të sjellin së bashku të gjithë mbledhësit e të dhënave për t'i hartuar indikatorët e nevojshëm për monitorimin dhe vlerësimin e punësimit dhe politikave të tregut të punës<sup>3</sup>.

Kushtet në tregun e punës mbesin të vështira (tabela 2.1). Indikatorët kyç siç janë niveli i pjesëmarrjes në fuqinë punëtore dhe shkalla e punësimit janë të ulëta sipas standardeve ndërkombëtare, derisa shkalla e papunësisë është shumë e lartë. Bazuar në HFP-në e botuar rishtazi për vitin 2007, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore e definuar si pjesë e personave të punësuar dhe të papunësuar në totalin e popullsisë me moshë të punës (15-64 vjeçare) ishte 46.8% - shkalla më e ulët në rajon. Shkalla e ulët e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është kryesisht rezultat i popullsisë së madhe të re,

<sup>1</sup> ESK, Hulumtimi i Fuqisë Punëtore (2007)

<sup>2</sup> Kalkuluar duke e përdorur shkallën e pjesëmarrjes së të rinjve të grupmoshës 15-24.

<sup>3</sup> Hulumtimet e firmave apo hulumtimet e aftësive të punëdhënësve duhet të zhvillohen rregullisht për të analizuar ndryshimet në kërkesat për punë.

dekurajimit të punëtorëve dhe pjesëmarrjes së ulët në mesin e femrave. Derisa shkalla e aktivitetit për meshkuj ishte 65.2% në vitin 2007, shkalla e krahasueshme për femra ishte vetëm 28.3%. Krahasuar me vitin 2005, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vitin 2007 shënoi rënie prej 2.4 përqind kryesisht si rezultat i shkallës në rënie të aktivitetit për meshkuj dhe femra<sup>4</sup>.

**Tabela 1: Indikatorët kyç të tregut të punës në përqindje (2005-2007)**

	2003		2005		2007	
	Të gjithë	Femrat	Të gjithë	Femrat	Të gjithë	Femrat
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqi punëtore	50.3	29.3	49.2	29.9	46.8	28.3
Shkalla e punësimit	25.3	8.3	28.5	11.7	26.5	12.7
<b>Shkalla e papunësisë</b>	<b>49.7</b>	<b>71.9</b>	<b>41.4</b>	<b>60.5</b>	<b>43.6</b>	<b>55.2</b>

Burimi: ESK, Hulumtimet e Tregut të Punës (2003- 2007)

Qasja e kufizuar në vende të punës është brengë e madhe, dhe performanca për krijimin e vendeve të reja të punës është larg nga ajo që është pritur. Në periudhën 2005-2007, shkalla e punësimit<sup>5</sup> shënoi rënie përkundër rritjes vjetore ekonomike prej rreth 4%<sup>6</sup> dhe mbetet shumë e ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Shkalla e punësimit të femrave është poashtu jashtëzakonisht e ulët me rreth 13%.

**Tabela 2: Indikatorët kyç të tregut të punës në vendet e zgjedhura (2007)**

Vendet / Indikatorët kyç të tregut të punës	Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës		Shkalla e punësimit		Shkalla e papunësisë	
	Të gjithë	Femrat	Të gjithë	Femrat	Të gjithë	Femrat
EU 27	70.5	63.4	65.4	58.3	7.1	7.8
EU 15	72.1	64.8	67.0	59.7	7.0	7.8
Bullgaria	66.3	62.1	61.7	57.1	6.9	7.3
Kroacia	63.4	56.4	57.1	50.0	9.6	11.2
Maqedonia	55.7	44.1	36.2	28.4	34.9	35.5
Mali i Zi	61.0	53.0	49.2	41.9	19.4	21.0
Serbia	51.0	42.8	41.8	33/8	18.8	21.0
<b>Kosova</b>	<b>46.8</b>	<b>28.3</b>	<b>26.5</b>	<b>12.7</b>	<b>43.6</b>	<b>55.2</b>

Burimi: Eurostat dhe Hulumtimet e Fuqisë Kombëtare të Punës

Struktura e punësimit në bazë të sektorëve në vitin 2007 tregon që sektori i shërbimeve është ofertuesi më i madh i punësimit në Kosovë, dhe përbën rreth 71% të punësimit total. Përbrenda sektorit të shërbimeve, tregtia dhe arsimit janë nën-sektorët më të

<sup>4</sup> Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore për meshkuj shënoi rënie nga 68.3% në vitin 2005 në 65.2% në 2007.

<sup>5</sup> Definuar si numri i punëtorëve të punësuar të ndarë sipas grupmoshave (15-64 vjeçar).

<sup>6</sup> Kur rritja ekonomike nuk shoqërohet me rritje të punësimit, atëherë kjo duhet të bëhet nëpërmjet rritjes së produktivitetit.

mëdhenj (me 16.9% dhe 12.1%). Bujqësia përbën rreth 14.6% të punësimit total, derisa industria ka rreth 14.1% (dhe prodhimtaria me rreth 10.4%). Krahasuar me vitin 2005, tregtia, arsimit dhe shërbimet tjera shënuan rritje në punësim, derisa bujqësia dhe ndërtimtaria shënuan rënie. Kalimi nga bujqësia në shërbime e konfirmon trendin të cilin e kanë përjetuar edhe vendet në zhvillim e sipër dhe ato në tranzicion. Hisa e madhe e bujqësisë (mbi 18% në vitin 2005) në punësimin total është indikacion i humbjeve të mëtutjeshme të vendeve të punës në dritë të modernizimit të ardhshëm në viset rurale.

**Tabela 3: Punësimi në sektorët kryesor ekonomik (përqindja)**

Sektorët kryesor ekonomik	2005	2007
Bujqësia	18.8	14.6
Industria	14.4	14.1
Shërbimet	66.8	71.3
Total	100	100

*Burimi: ESK), Hulumtimi i Fuqisë Punëtore (2005-2007)*

Ekziston një marrëdhënie pozitive në mes shkallës së punësimit dhe arsimit pasi që HFP për vitin 2007 tregon që 74.7% të njerëzve me arsim të lartë terciar janë punësuar kundër 32.7% të atyre me arsim të mesëm. Dallimi i dukshëm i shkallëve të punësimit në mes këtyre grupeve mund t'i atribuohet pjesërisht mungesës së sistemit të pranueshëm të kualifikimeve i cili do t'i detyronte punëdhënësit ta përdorin arsimin universitar si bazë për kualifikime të vendeve të punës.

Siç u tha më lart, shkalla e papunësisë në Kosovë është jashtëzakonisht e lartë. Të dhënat nga HFP për vitin 2007 tregojnë që rreth 43.6% e fuqisë punëtore është e punësuar: rreth 2.2 pikë të përqindjes më e lartë se në vitin 2005. Shkalla e papunësisë në Kosovë është pothuajse dy herë më e lartë se shkalla mesatare e papunësisë në Ballkanin Perëndimor.

Shkalla e papunësisë është posaçërisht e lartë në mesin e të rinjve, femrave dhe individëve me shkollim të kufizuar. Të rinjtë kosovar kanë dy herë më tepër gjasa se të rriturit të jenë të papunësuar dhe kalojnë nëpër një periudhë shumë të gjatë të tranzicionit nga shkolla në punë<sup>7</sup>. Përkundër shkallës relativisht të ulët të pjesëmarrjes në mesin e femrave, shkalla e papunësisë të femrave është 11.6 përqind më e lartë se përqindja e tërë fuqisë punëtore. Personat me nivel më të ulët të arsimit kanë më tepër gjasa të jenë të papunësuar. Afro 55% të papunësuarve nuk e kanë mbaruar as shkollimin sekondar.

Një çështje tjetër që paraqet brengë serioze është kohëzgjatja e gjatë e papunësisë meqë afro 85% të papunësuarve në vitin 2007 kanë ngelur pa punë për më tepër se një vit. Përveç kësaj, 81.7% e të papunësuarve (dhe 97.6% të papunësuarve në grupmoshën 15-24) nuk kanë fare përvojë të punës, gjë që tregon për rëndësinë e kontaktit të parë me tregun e punës dhe/apo përvojën e punës për të siguruar punësim të qëndrueshëm.

<sup>7</sup> Banka Botërore raporton që meshkujve të rinj ju duhen rreth 10 vite për të kaluar nga shkolla në punë në Kosovë, derisa në Maqedoni duhen katër deri në pesë vite dhe në vendet e zhvilluara edhe më pak kohë (Banka Botërore: Rinia në rrezik: Të jesh i ri, i papunë dhe i varfër në Kosovë, 2008).

Niveli i lartë i papunësisë është determinant kyç i varfërisë së gjerë në Kosovë. Sipas Vlerësimit të Varfërisë në Kosovë (2007), rreth 45% të popullsisë ka nivele të konsumimit nën linjën e varfërisë, dhe një e treta e të varfërve mendohet të jetojnë në varfëri të skajshme, siç dëshmon pamundësia e përmbushjes së nevojave minimale ushqimore. Megjithatë, varfëria në Kosovë është relativisht e cekët, dhe rritja e nivelit të punësimit do të kishte ndikim të dukshëm në uljen e varfërisë dhe në vendosjen e vendit në një rrugë më të barabartë të rritjes.

Edhe pse nuk ka mbulim të plotë në mes të papunësisë dhe varfërisë<sup>8</sup>, rreziku i varfërisë është shumë më i madh për të papunësuarit. Një krahasim i incidencës së varfërisë në mes të punësuarve dhe të papunësuarve tregon që këta të fundit kanë 20% më tepër rrezik të jetojnë në varfëri sesa kategoria e parë, me fjalë tjera gjasat për të qenë i varfër janë shumë më të mëdha nëse personi është i papunë.

### *Cilësia e Punësimit*

Qasja e kufizuar në vende të punës nuk është problemi i vetëm në tregun e punës. Edhe në rastin e vendeve ekzistuese të punës ka sfida të jashtëzakonshme.

Punësimi joformal është<sup>9</sup> karakteristikë e rëndësishme e tregut të punës në Kosovë, edhe pse ka mungesë të informatave dhe analizave për madhësinë dhe karakteristikat e tij të përgjithshme. Derisa Hulumtimi i Fuqisë Punëtore nuk përmban informata për punësimin joformal, disa vlerësime mund të llogariten duke e krahasuar numrin e përafërt të punëtorëve nga HFP-ja me numrin e punëtorëve të regjistruar për qëllime të tatimeve në rrogë sipas raportimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Bazuar në këtë llogaritje, rreth 50% e tërë punësimit në Kosovë ishte joformale në vitin 2007. Studimi shkollë-punë i Organizatës Ndërkombëtare të Punës poashtu ofron një shkallë të ngjashme për punëtorët e rinj.<sup>10</sup> Shkalla e joformalitetit bëhet edhe më e shprehur nëse vlerësohet në bazë të asaj se a i kanë respektuar ndërmarrjet kontributet tatimore dhe pensionale, meqë 67% të punëtorëve të rinj nuk janë të regjistruar në sistemin e sigurimit social.<sup>11</sup>

Për punëtorët, të qenit i punësuar joformal shpeshherë është mënyra e vetme për sigurimin e vendit të punës në një ekonomi me shkallë shumë të lartë të papunësisë. Punësimi i përhapur joformal mund të ketë disa pasoja për ekonominë dhe shoqërinë e një vendi. Ky lloj i punësimit iu mohon punëtorëve mbrojtjen dhe të drejtat në vendin e punës dhe kështu i ul standardet e punës në përgjithësi. Niveli i lartë i punësimit joformal mund të ketë edhe ndikim negativ fiskal meqë i ul të hyrat e qeverisë.

---

<sup>8</sup> Jo të gjithë të papunësuarit jetojnë në ekonomi të varfra familjare, dhe jo të gjithë të papunësuarit janë të lirë nga varfëria.

<sup>9</sup> Definicioni i gjerë i punësimit joformal përfshin vetëpunësimin në ndërmarrje joformale dhe në vende joformale të punës në ndërmarrje formale.

<sup>10</sup> V. Corbanese, G.Rosas; Young People's Transition to Decent Work: Evidence from Kosovo, ILO Employment Policy Papers 2007/4

<sup>11</sup> V. Corbanese, G.Rosas; Young People's Transition to Decent Work: Evidence from Kosovo, ILO Employment Policy Papers 2007/4

Edhe pse punësimi joformal është karakteristikë e rëndësishme e tregut të punës në Kosovë, në këtë fushë janë bërë shumë pak hulumtime. Prandaj, si pjesë e strategjisë përmbajtësore të punësimit, burimet e të dhënave primare që mbulojnë punësimin joformal do të përmirësohen me analiza pasuese.<sup>12</sup>

Tregu i punës në Kosovë karakterizohet me hise relativisht të lartë të punësimit të përkohshëm, me orar të shkurtuar dhe vetëpunësimit. Hise e punësimit të përkohshëm si përqindje e totalit të nëpunësve ka shënuar rënie por mbetet e lartë me 51.5%.<sup>13</sup> Hise korresponduese e vendeve të punës me orar të shkurtuar është rreth 17%, edhe pse kjo hise është shumë më e madhe për femra sesa për meshkuj (28% dhe 13%). Hulumtimi shkollë-punë i kryer nga Organizata Ndërkombëtare e Punës tregon që rreth 72% e të gjithë të rinjve që punojnë në baza të përkohshme thonë se veprojnë kështu sepse nuk mund të gjejnë vende të punës me orar të plotë.<sup>14</sup> Vetëpunësimi vazhdon të kontribuoj me rreth 21% të punësimit të përgjithshëm dhe është alternativë për punësimin me rrogë kur është vështirë të arrihet ky i fundit.

Duhet theksuar se ka shumë punëtorë që janë të angazhuar në vende të punës me paga të ulëta dhe me produktivitet të ulët të cilët nuk fitojnë mjaft para për t'u shkëputur nga varfëria. Vlerësimi i Bankës Botërore për Varfërinë në Kosovë raporton që të varfërit që punojnë përbëjnë deri 35% të atyre që jetojnë në linjën e varfërisë.<sup>15</sup> Në mesin e të punësuarve, punëtorët me pagë ditore<sup>16</sup> dhe ekonomitë familjare bujqësore të vetëpunësuarve e kanë incidencën më të lartë të varfërisë. Inçidenca e lartë e varfërisë në mesin e të papunësuarve dhe ndarja domethënëse e të varfërve që punojnë, dëshmojnë nevojën për promovimin e qasjes më të mirë në vende të punës dhe cilësi më të lartë të vendeve të punës si rrugë kyçe drejt uljes së varfërisë.

### **Kufizimet kyçe të tregut të punës**

Siç u tha edhe në seksionin më lart, përkundër rritjes ekonomike të kohëve të fundit, kushtet e tregut të punës nuk janë përmirësuar. Përderisa mospërputhjet në mes të rritjes së kërkesës për punë dhe aftësive i kanë kontribuar këtij rezultati zhgënjyes, niveli joadekuat i kërkesës për punë mbetet kufizimi kyç. Kërkesa për punë nuk ka mjaftuar për futjen e fuqisë së re punëtore dhe për uljen e numrit të papunësuarve.

Thënë më gjerësisht, mënyra më e mirë për përmirësimin e kushteve të tregut të punës është *të rritet kërkesa për punë dhe njëkohësisht të pajiset fuqia punëtore me cilësitë e nevojshme për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate kësaj kërkesë*. Rritja e kërkesës për

---

<sup>12</sup> Analiza e hollësishme e punësimit joformal mund të përqendrohet në temat vijuese: shkalla e përgjithshme dhe format e ndryshme të punësimit joformal (ndarja e punësimit joformal), rreziqet e varfërisë dhe zbrazëtirat nga çdo formë e punësimit joformal, shkaqet e ndryshme të punësimit joformal, etj.

<sup>13</sup> Rreth 30% të të gjithë të rinjve janë të punësuar në baza të përkohshme me kontrata prej së paku 6 muaj.

<sup>14</sup> V. Corbanese, G.Rosas; Young People's Transition to Decent Work: Evidence from Kosovo, ILO Employment Policy Papers 2007/4.

<sup>15</sup> World Bank. Kosovo Poverty Assessment: Accelerating Inclusive Growth to Reduce Widespread Poverty. Report No. 39737-XK. 2007. Washington, DC.

<sup>16</sup> Kryesisht punëtorë të rëndomtë që paguhen për detyrat specifike.

punë është poashtu kusht i nevojshëm për përmirësimin e cilësisë së vendeve të punës. Për shkak të tepricës të dukshme të punës, nevoja e shtuar për punë do të çonte në punësim më të madh dhe do ta ulte papunësinë. Më vonë, me shterrjen e tepricës së punës, shumica e ndikimit do të ndihej në nivelet e ulëta të punësimit sezonal/të përkohshëm dhe në punësimin me gjysmë orari së bashku me kthimet e mëdha në punë.

Arritja e këtij synimi është sfidë afatgjate dhe duhet të adresoj disa kufizime në fushat vijuese:

- 1) Mjedisit i investimeve paraqet kufizime që e pengojnë hyrjen dhe zgjerimin;
- 2) Sistemet e arsimit dhe trajnimit nuk shënojnë arritje të mjaftueshme në rritjen e punësimit;
- 3) Institucionet politikat dhe rregulloret ekzistuese të tregut të punës, nuk janë bazë e mjaftueshme për përmirësimin e funksionimit të tregut të punës.

### *Kufizimet kyçe në arsim, aftësi dhe trajnim*

Ekzistojnë argumente të dokumentuara për rëndësinë e fuqisë punëtore të arsimuar mirë për konkurrencën dhe rritjen e ekonomisë së një vendi. Njerëzit me aftësi më të shquara janë më të suksesshëm në ndërmarrjet e tyre. Aftësitë poashtu janë faktor i rëndësishëm të cilin investitorët e huaj e marrin parasysh kur vendosin se ku do të investojnë. Pavarësisht nga përmirësimet e dukshme që janë bërë, akoma mbesin sfida për arritjen e relevancën dhe efikasitetin e arsimit dhe trajnimit, si dhe për vlerësimin e rezultateve. Mungesa e aftësive relevante poashtu kufizon aftësinë e shumë njerëzve që të përfitojnë nga punësimi produktiv dhe t'i kryejnë detyrat që kërkohen nga punëdhënësit e tyre. Arsimi dhe trajnimi cilësor që i përgjigjen kërkesave të tregut të punës janë në përputhje me përmirësimin e produktivitetit dhe konkurrencës.

### *Arsimi profesional*

Më tepër se 60% e shkollave të mesme në Kosovë ofrojnë kurse të arsimit profesional. Pothuajse 2/3 e këtyre shkollave kanë shumë pak ose fare pajisje për ta lehtësuar ndërveprimin praktik në mes mësimdhënësve dhe studentëve. Poashtu nuk ka lidhje strukturore në mes shkollave profesionale dhe mjedisit lokal ekonomik. Në shumicën e shkollave, kurset e arsimit dhe trajnimi profesional ofrohen pa i marrë parasysh nevojat e tregut të punës dhe sektori privat nuk merr pjesë në mënyrë sistematike në planifikimin dhe ofrimin e trajnimit praktik në-ndërmarrje.<sup>17</sup> Shumica e shkollave nuk kanë tekste shkollore e as module për mësim praktik. Bazuar në vlerësimet fillestare, një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve nuk kanë kualifikime adekuate për kurset të cilat i ligjërojnë dhe për metodat e mësimdhënies. Përveç kësaj, menaxhmenti i shkollave varet kryesisht nga përkushtimi personal dhe aftësia menaxheriale e drejtorëve të shkollave, e cila dallon nga një shkollë në tjetrën. Instruktorët që kanë mandatin për të monitoruar standardet dhe njohurinë praktike të kurseve dhe profileve respektive duhet të ngriten në post në përputhje me standardet, kriteret dhe normat e afirmuara të kurseve respektive.

---

<sup>17</sup> Me zhdukjen e ndërmarrjeve publike, shkollat profesionale humbën partnerët e tyre tradicional për trajnime të bazuara në punëtori.

Shkollat akoma nuk kanë autonomi për menaxhimin e administratës dhe burimeve të tyre financiare.

### *Sistemi i trajnimit profesional*

Në Kosovë, nuk është sistematizuar ofrimi i trajnimit profesional nga sektori privat, sektori joprofitabil dhe sektori publik. Aktualisht, certifikimi ofrohet nga institucionet e trajnimit në bazë të aranzhimeve jashtëzakonisht të ndryshueshme të ekzaminimit dhe testimit. Këta faktorë aktualisht paraqesin pengesë për ngritjen e standardeve të cilësisë në sistemin e trajnimit në Kosovë dhe për njohjen e standardeve, njohurive dhe kompetencave të arritura jashtë programeve formale të mësimi. Edhe pse Ligji për Kualifikime është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) ende nuk është definuar, e as nuk është themeluar Autoriteti Kombëtar për Kualifikime (AKK) për akreditimin e të gjitha institucioneve që ofrojnë arsim dhe trajnim profesional. Së bashku me Ligjin për Arsim dhe Trajnim Profesional, këto tri mekanizma ofrojnë hapësirë për përmirësim të cilësisë dhe ofrimin të ATP dhe mësimi gjatë gjithë jetës. Edhe pse është përgatitur dokumentacioni dhe korniza ligjore për themelimin e KKK-së, në mungesë të studimeve dhe analizave relevante, sfida e njëmendtë do të jetë caktimi i standardeve kombëtare të kompetencave të orientuara drejt nevojave të tregut të punës. Poashtu, themelimi i AKK-së dhe operacionalizimi i tij do të jetë i vështirë për shkak të nevojës për akreditimin dhe licencimin e qindra trajnuesëve dhe institucioneve formale për module të ndryshme të trajnimit.

Përveç çështjeve që lidhen me kornizën kombëtare të kualifikimeve, ofrimi i trajnimeve për të papunëuarit akoma mbetet shumë i kufizuar. Programet e trajnimit për tregun e punës ofrohen nëpërmjet rrjetit të tetë qendrave për trajnim profesional dhe nga disa institucione të trajnimit që janë partnere të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Edhe pse këto programe janë përmirësuar në cilësi dhe sasi, ato ende iu shërbejnë vetëm një numri të kufizuar të aplikantëve (më pak se një për qind e të papunësuarve të regjistruar) dhe fleksibiliteti dhe relevanca e tyre nuk e ka mbajtur hapin me kërkesat e ndryshueshme të tregut të punës<sup>18</sup>. Aktualisht nuk ekziston ndonjë sistem për matjen e relevancës dhe efikasitetit të kostos së këtyre trajnimeve.

### *Arsimi i Lartë*

Njëra prej sfidave kyçe për lidhjen e arsimit të lartë me nevojat e ekonomisë është krijimi i standardeve dhe kriterëve kualitative dhe sistematike në universitetet publike (Universiteti Publik i Prishtinës dhe Universiteti Publik i Mitrovicës) dhe në sektorin privat. Një sfidë tjetër lidhet me nivelin e ulët të kapaciteteve hulumtuese dhe shkencore në Kosovë, si dhe kapaciteteve për thithjen e transfereve të teknologjisë. Dobësia e fundit lidhet me mungesën e marrëdhënies së qartë në mes të universiteteve dhe sektorit privat, për të cilat po hartohet një ligj i veçantë. Lidhja e kapaciteteve hulumtuese-shkencore me

---

<sup>18</sup> Sipas një studimi të zhvilluar nga OBP në vitin 2007, vetëm 27% e të diplomuarve VTC në vitin 2006 gjetën vende të punës atë vit.



sektorin privat mund të çoj në kapacitete më të larta prodhuese dhe numër më të madh të vendeve të punës.

### **Rregulloret specifike për ATP**

Sistemi i Arsimit Profesional të cilin shumë vende e kanë trashëguar nga e kaluara ka qenë njëra prej mundësive të studentëve me sukses më të vogël. Statusi i ulët i arsimit profesional dhe fakti që rezultatet e programeve të tij nuk ishin aq të qarta e kanë bërë atë më pak joshës për studentët.

Arsimi Sekondar Profesional apo Shkollat Profesionale synojnë t'i përgatisin studentët për tregun e punës, dhe sipas strategjisë për arsim profesional dhe ligjit për arsim dhe trajnim profesional ato poashtu ofrojnë mundësi për aplikimin e studentëve në arsimin e lartë post-sekondar dhe në arsimin universitar.

Kohëzgjatja e arsimit të lartë sekondar profesional, si pjesë e arsimit parauniversitar, është e rregulluar në tri nivele. Niveli i parë përfshin klasat 10+11. Ky nivel ofron kualifikimet bazike dhe mundëson punësimin në tregun e punës si punëtor gjysmë i kualifikuar. Niveli i dytë, është vazhdimësi e nivelit të parë, dhe përfshin klasën 12 – ai ofron punësim në tregun e punës si punëtor i kualifikuar. Në këto dy nivele të para, mund të krijohet kuadro profesionale dhe kompetente për punë të kualifikuar në tregun e punës, por nuk garantohet përgatitja akademike për studime të suksesshme në universitet. Arsyeja për këtë është që për t'i përmbushur nevojat e tregut të punës, planprogrami i këtyre shkollave ka 60% teori dhe vetëm 40% praktikë profesionale. Prandaj është hartuar koncepti i klasës së 13-të i cili iu ofron studentëve dy mundësi: 1) ta marrin diplomën profesionale të maturës e cili iu hap mundësinë e studimeve në universitet dhe 2) ta marrin kualifikimin e nivelit të tretë për arsim profesional i cili ofron gjasa më të mira për punësim dhe iu hap dyert për nivelin e katërt i cili çon tek kualifikimi si teknik. Vendimi administrativ për arsim të mëtutjeshëm është miratuar rishtazi dhe në vijim i kemi shpjeguar detajet e këtij vendimi. Kjo formë e arsimit profesional është praktikë e shumë vendeve Europiane.

Nëse Ministria ka sukses në zbatimin e këtij sistemi, atëherë Kosova do të jetë në rrugë të duhur për ndërtimin e sistemit fleksibil të arsimit dhe trajnimit profesional i cili do t'iu lehtësoj punën dhe jetën të gjithëve në të ardhmen, dhe i cili do të jetë në harmoni me shumicën e sistemeve në vendet e BE-së. Ligji për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në Kosovë (i miratuar rishtazi) synon të ndërtojë një sistem kualitativ, të kontribuojë në zhvillimin e aftësive për punë dhe në qytetarinë aktive të rinjve dhe të rriturve, sistem i cili ofron kualifikime profesionale në përputhje me kushtet ekonomike dhe shoqërore të vendit në kontekstin e integritit rajonal dhe Europian.

Siç u tha më lart, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë rishtazi ka miratuar një udhëzim administrativ i cili synon të rregulloj Shkollat e Larta Profesionale dhe Shkollat e Larta Teknike në Kosovë.<sup>19</sup>

<sup>19</sup> Ky udhëzim bazohet në nenet 4, 11, 23.3 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë (ALK: 2002/3), nenet 2, 5, 6 dhe 10 dhe 14.2 të Ligjit për Kualifikime Kombëtare (LKK: 2008/060), Udhëzimi Administrativ për

Ky Udhëzim ka për qëllim të shtroj principet, përgjegjësitë dhe procedurat e përgjithshme për akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës.

Kërkesat e përgjithshme:

- Programet profesionale dhe të larta në nivelin e arsimit të lartë post-sekondar (p.sh. në Nivelin e 5 dhe më lartë të KEK/KKK) mund të ofrohen nga ofertuesit publik dhe privat të arsimit dhe trajnimit profesional, të akredituar nga Agjencioni Kosovar i Akreditimit (AKK) dhe të licencuar nga MASHT-i qoftë si Shkolla të Larta Profesionale apo si Shkolla të Larta Teknike.
- Në rastet kur një Institucion ofron shërbime në Nivelin 6 apo më lartë të KEK/KKK, ai mund të aplikojë për licencë si Shkollë e Lartë Profesionale. Kur shërbimet ofrohen në Nivelin e 5 të KEK/KKK, ai mund të licencohet si Shkollë e Lartë Teknike. Shkolla e Lartë Profesionale mund të ofroj shërbime edhe në Nivelet 4 dhe 5 të KEK/KKK. Shkolla e Lartë Teknike mund të ofroj shërbime në Nivelin 4 të KEK/KKK. Shërbimet në nivelin 4 duhet të dizajnohen për të ofruar rrugë deri në kualifikimet e nivelit të lartë për ata studentë (zakonisht të rritur) që mund të demonstrojnë kompetenca praktike në fushën profesionale por të cilët nuk kanë kualifikim formal në Nivelin 4. Institucioni i cili ofron shërbime vetëm në Nivelin 4, nuk mund të aplikojë për akreditim si Shkollë e Lartë Profesionale apo si Shkollë e Lartë Teknike.
- Asnjë Shkollë e Lartë Profesionale apo Shkollë e Lartë Teknike nuk mund të lëshojë diploma profesionale. Vetëm Institucionet e Shkencave të Aplikuara mund të lëshojnë diploma profesionale siç ceket në Nenin 12 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë.

### **Akreditimi nga AKK**

- Të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit të lartë dhe profesional në Kosovë, programet studimore të të cilave përfshijnë marrjen e diplomës akademike apo mirënjohjes profesionale në Nivelin e 5 apo më lartë KEK/KKK, mund të jenë kandidatë për akreditim në AKK. Ata mund të jenë:
  - a. Institucionet aktive publike apo private të arsimit të lartë dhe profesional në Kosovë;
  - b. Një institucion i ri i arsimit që synon të ofrojë programe studimore në sektorin privat të arsimit profesional;
  - c. Institucion i akredituar i arsimit të lartë apo profesional që synon të ofrojë programe të reja studimore;

---

Licencimin e Institucioneve Private të Arsimit të Lartë (AI14/2003), Udhëzimi Administrativ për Themelimin e Agjencionit Kosovar për Akreditim (AI 11/2004); Udhëzimi Administrativ për Shkollën (Akademinë) e Administrimit Arsimor (AI 17/2005); Udhëzimi Administrativ për zbatimin e ECTS-së në Kosovë (AI 14/2008); dhe Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë (AI 2/2009).

- d. Institucion i akredituar i arsimit të lartë apo profesional që dëshiron ta zgjas akreditimin për një periudhë të caktuar kohore – me fjalë tjera që kërkon akreditim të sërishëm.

Akreditimi mund të bëhet në nivel të:

- a. Institucioneve
- b. Programeve Studimore
- c. Edhe institucioneve edhe programeve studimore

Ofertuesi i arsimit të lartë apo profesional që aplikon për akreditim si Shkollë e Lartë Profesionale apo Shkollë e Lartë Teknike duhet ta dorëzoj aplikacionin në AKK së paku një vit para datës kur planifikohet të filloj procesi i akreditimit.

Në rastet kur aplikacioni dorëzohet për program studimor në Nivelin 5 apo më të lartë të KEK/KKK-së, AKK-ja do të jetë kompetent për miratimin e kualifikimeve të cilat i udhëheq programi, në pritje të themelimit të plotë të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve të Kosovës. Pas kësaj, do të bëhet miratimi në pajtim me AKK. Gjatë miratimit të kualifikimit të Nivelit 5 apo më lartë KEK/KKK, AKK-ja do të aplikojë filozofinë, kriteret dhe standardet e specifikuar në Kornizën Europiane të Kualifikimeve.

### **Konkludime dhe Rekomandime**

Marrë parasysh të gjitha nismat (si dhe nismat tjera potenciale), është me rëndësi të përqendrohemi në zbrazëirat dhe të ofrojmë disa rekomandime për Ministrinë:

1. Shkollat e mesme profesionale nuk i përmbushin në mënyrë adekuate nevojat e ndërmarrjeve për fuqi punëtore të aftë dhe të punësueshme. Kjo paraqet një pengesë të madhe për zhvillimin ekonomik dhe për procesin e tranzicionit në Kosovë.

Strategjia e trajnimit profesional e orientuar kah industria në të cilën bazohet projekti i ATP-së, bie nën fushën prioritare të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Promovimi i arsimit dhe trajnimit profesional është përqendrim sektorial i zhvillimit dhe do të duhej të kontribuonte në rritjen ekonomike duke i ofruar industrisë dhe bizneseve një fuqi të kualifikuar punëtore.

*Rekomandim: Ministria duhet të ndërmarr iniciativën dhe të krijojë Bordin Kombëtar për ATP i cili do të përbëhet nga përfaqësues të industrisë. Industria duhet të jetë forca kryesore shtytëse e agjendës ATP*

2. Sistemi i Arsimit Profesional të cilin shumë vende e kanë trashëguar nga e kaluara ka qenë njëra prej mundësive të studentëve me sukses më të vogël. Statusi i ulët i arsimit profesional dhe fakti që rezultatet e programeve të tij nuk ishin aq të qarta e kanë bërë atë më pak joshës për studentët.

*Rekomandim: Ministria duhet të organizojë fushata publike për promovimin e përfitimeve nga arsimit dhe trajnimit profesional. Fushatat duhet t'iu prezantojnë të rinjve rrugët e qarta të karrierës dhe t'i bëjnë shkollat ATP më joshëse.*

3. Ministria duhet ta bëjë sistemin më reaktiv ndaj nevojave të tregut të punës dhe ta përkrahë konkurrencën, politikat do të përqendrohen në krijimin e fleksibilitetit më të madh në arsimin profesional dhe më relevant ndaj nevojave të tregut të punës dhe më joshës ndaj gamës sa më të gjerë të të rinjve. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) duhet ta ndjekë reformën e arsimit profesional për të shërbyer si urë lidhëse në mes arsimit dhe trajnimit formal dhe botës së punës.

*Procesi i reformave duhet të ndërtohet mbi tri shtylla: a) krijimi i shkollave të veçanta të quajtura Qendra të Kompetencës (në proces e sipër) b) forcimi i lidhjes në mes shkollës dhe punës dhe c) delegimi i mëtutjeshëm i përgjegjësisë te shkollat.*

4. Masat kyçe të politikave për sistemin e trajnimit profesional përfshijnë: a) Përmirësimin e qasjes në arsim të të rriturve dhe mundësive për mësim gjatë gjithë jetës dhe b) dizajnimin dhe zbatimin e kornizës së përgjithshme të kualifikimeve. Zgjerimi i arsimit të të rriturve dhe i mundësive për trajnim tashmë po ndiqet njëkohësisht me dizajnimin e Qendrave të Kompetencës dhe shkollave profesionale për trajnim të të rriturve. Këto institucione do të kontraktojnë, sa herë që është e mundur, ofrues të jashtëm, kryesisht ndërmarrje, por edhe qendra të trajnimit të bazuara në komunitete.

*Kur i cakton këto, Ministria (MASHT) duhet të:*

*a) definojë dhe zbatojë Kornizën Kombëtare të Kualifikimit e cila përbëhet nga standardet kombëtare të kompetencave të orientuara drejt nevojave të tregut të punës në pajtueshmëri me Kornizën Europiane për Kualifikime dhe*

*b) të ndërtojë një sistem të certifikimit të aftësive që njihen dhe mund të barten në ndërmarrje*

### **1.3 Njohja e kredive nga kurset në njësitë akademike jo-amë në Universitetin e Prishtinës**

*Autore:* Valentina Qarri, SPARK

*Mirënjohje:* Ass. Prof. Dr Ferdije Zhushi-Etemi, Kryetare e Këshillit Kombëtar të Cilësisë në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës; Prof. Dr. Dukagjin Pupovci, Drejtor Ekzekutiv, Qendra për Arsim e Kosovës; Prof. Dr. Luan Ahma, Pro-Rektor për mësimdhënie dhe kërkime shkencore në Universitetin e Prishtinës; Msc. Mimoza Ibrani – Pllana, Drejtor i Zyrës për Zhvillim Akademik në Universitetin e Prishtinës

#### **Hyrje**

Procesi i reformimit në Universitetin e Prishtinës (UP) i referohet Deklaratës së Bolonjës, të cilën UP ka filluar së zbatuari që nga viti akademik 2001-02. Në përputhje me këtë deklaratë kërkohet që e tërë veprimtaria e universitetit të zhvillohet në pajtueshmëri të plotë me këtë dokument.

Përbrenda procesit të Bolonjës, Universiteti i Prishtinës poashtu ka realizuar dhe zbaton Sistemin European për Tranfer të Kredive ( ECTS), që është sistem për transfer dhe akumulim të kredive i cili është i orientuar kah studenti, që njëkohësisht inkurajon mobilitetin e studentëve dhe të të diplomuarëve në vendet e Bashkimit European dhe vendet e tjera që e kanë adaptuar dhe janë nënshkrues të kësaj deklaratë. ECTS tregon përpjekjen e studentëve për të arritur qëllimet për programet e veçanta gjatë studimit të tyre, dhe i vlerëson ata. Përderisa qëllimet duhet të sqarohen përmes rezultateve të pritura dhe aftësive të cilat duhet të zhvillohen - (sipas U.A. Nr. 14/2008, Neni 2, Pika 1). Ligji nr. 2003/14 për Arsimin e Lartë në Kosovë, Udhëzuesi Administrativ nr. 2008/14 i nxjerrë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës ( MASHT), - të parapara dhe në harmoni edhe me Deklaratën e Bolonjës, rekomandojnë institucionet e arsimit të lartë, në këtë rast edhe Universitetin e Prishtinës, të mundësojnë zbatimin e plotë të Sistemit European për Transfer të Kredive.

Megjithatë, funksionimi i UP-së në njohjen e kredive akademike jo-amë mbetet ende shqetësim i studentëve, administratës dhe personelit akademik. Mungesa e një politike në këtë çështje dhe veprimeve konkrete të UP-së për të zbatuar si kërkohet ECTS, e pengon mobilitetin e studentëve, e kufizon shkëmbimin e dijës dhe mundësitë e studentëve të UP-së për të fituar përvojë dhe studiuar në institucione të tjera të arsimit të lartë jashtë vendit. Prandaj, Universiteti i Prishtinës duhet të sigurojë realizimin, gjegjësisht zbatimin e plotë të ECTS, në mënyrë të qartë dhe transparente, ashtu që të kuptohet e zbatohet drejtë nga studentët, personeli akademik dhe administrata.

## **Në Universitetin e Prishtinës, ECTS nuk shërben për qëllimet e parapara**

Bazuar në “Udhëzuesin për përdorimin e ECTS”, kreditë e fituara në një program mund të transferohen në një program tjetër që ofrohet nga i njëjti apo tjetër institucion. Universiteti i Prishtinës, bashkë me organet e tij ( kryesisht përmes Zyrës për zhvillim akademik ) e mundëson zbatimin e Sistemin Europian për Transfer të Kredive në aspekt teknik, por jo edhe aq në atë praktik sa që ky sistem të jetë i përdorshëm dhe efektiv. Andaj duhet të merren masa përmes të cilave UP do të sigurojë zbatueshmërinë e plotë të ECTS në harmoni me “Udhëzuesin për përdorimin e ECTS”.

Në Universitetin e Prishtinës ECTS vazhdon të shfrytëzohet më shumë si sistem akumulimi sesa si sistem i transferit të kredive e që përkrahë lëvizshmërinë e studentëve dhe cilësi më të mirë të arsimit, të njohurive, përvojave dhe gradave të fituara. Njohja e kredive për kurset akademike jo-amë (kurset akademike jo-amë konsiderohen kurset akademike të një institucioni tjetër, në një vend tjetër) në Universitetin e Prishtinës ende nuk është e qartë dhe e zgjidhur, ndaj kërkesat zakonisht zgjidhen nga rasti në rast.

Mungesa e një trajtimi të duhur dhe e një vendimi zyrtar për njohjen e kredive për kurset akademike jo-amë në Universitetin e Prishtinës vazhdon të pamundësojë lëvizshmërinë e studentëve, duke e lënë të pazgjidhur transferin e kredive të akumuluar në Universitetin e Prishtinës. Kjo nuk i shërben interesave dhe zbeh promovimin e ndërkombëtarizimin e Universitetit të Prishtinës, i cili nuk mund të dëshmojë zbatimin e plotë e si kërkohet të ECTS.

## **Universiteti i Prishtinës duhet të marrë masa sa më parë**

Njohja e kredive nga kurset akademike jo-amë në Universitetin e Prishtinës është çështje e brendshme e universitetit ndaj dhe duhet të zgjidhet si e tillë. Për të garantuar aspektin ligjor, Universiteti i Prishtinës duhet të hartojë dhe aprovojë rregullore të veçantë për zbatueshmërinë e plotë të ECTS. Krahas kësaj rregullore, UP duhet të themelojë mekanizma përcjellës që do të sigurojnë zbatueshmërinë e plotë të ECTS, në këtë rast edhe të njohjes së kredive nga kurset akademike jo-amë. Duhet të krijohen mekanizma të cilët do të mundësojnë njohjen e kredive nga kurset akademike jo-amë të institucioneve të arsimit të lartë (HEI) jashtë vendit, për sa i përket institucioneve të arsimit të lartë tani më të aprovuara nga UP-ja. Ndërsa, përmes krahasimit të planprogrameve relevante dhe duke përdorur metodat e rekomanduara duhet të bëhet përcaktimi i drejtë i gradave ( dhe / apo kredive) të fituara. Marrëveshjet e nënshkruara dhe të dyanshme ndërmjet UP-së dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë duhet të jenë metoda të cilat e përbëjnë bazën e njohjes, dhe që po ashtu bëjnë të mundur që studentët nga institucione të tjera të arsimit të lartë (jashtë vendit) të pranohen dhe të studiojnë në UP.

Në rast të kërkesave të tjera për transfer dhe njohje të kredive akademike jo-amë të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë jashtë vendit e që nuk janë në listë dhe pa marrëveshje, duhet të zhvillohen mekanizma të tjerë për njohje e që do të përfshijnë: mbledhjen e informatave të nevojshme nga vendi i origjinës i atij institucioni të arsimit të lartë, gjendjen e përgjithshme dhe statusi akreditues, sistemin e klasifikimit që aplikohet

në atë institucion si dhe informata të tjera që ndihmojnë mekanizmat për transfer dhe njohje.

## **Rekomandimet**

*Politika për njohjen e kredive nga kurset akademike jo-amë në Universtetin e Prishtinës*, përveç tjerash, siguron lëvizshmërinë e studentëve dhe të të diplomuarëve, promovimin dhe ndërkombëtarizimin e UP, dhe zbatimin e plotë të ECTS. Kjo politikë kërkon të ndërmerren këto veprime:

1. Të përpilohet dhe aprovohet( nga Senati i Universitetit të Prishtinës) rregullore e veçantë për transfer të kredive, gjegjësisht për njohjen e kredive nga kurset akademike jo-amë në Universitetin e Prishtinës;

Me këtë rregullore duhet të saktësohet qartë kur UP është e obliguar që të pranoj ECTS nga institucionet e tjera, posaqërisht në kuadër të shkëmbimit të studentëve në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera në vende të tjera, dhe në cilat raste duhet të shqyrtohet përputhshmëria e programeve të kurseve /kredive që transferohen.

2. Të përpilohen procedura administrative të veçanta për zbatimin e plotë të Sistemit Europian për Transfer të Kredive, të cilat do të ia mundësojnë administratës të ofrojë shërbime efektive, dhe studentëve transfer të lehtë dhe të qartë ;
3. Të themelohen mekanizma përcjellës, krahas nevojës, sidomos për fusha të caktuara, e që përkrahin e garantojnë funksionimin e zbatimin e plotë të ECTS-së ( të cilat do të jenë të përbashkëta për të gjitha njësitë akademike të UP);
4. Të jetë i obligueshëm përdorimi i dokumenteve standarde të ECTS, pa përjashtim;
5. ECTS të zbatohet plotësisht dhe të jetë i obligueshëm në nivel qëndror të UP;
6. Të mbajë takime të formave të ndryshme dhe të rregullta me studentë, administratë dhe personelin akademik në të cilat, përveç tjerash, do të nxitet lëvizshmëria e studentëve;
7. Të lidhë marrëveshje me universitete të tjera në shkëmbimin e studentëve dhe t'i realizojë ato në afate kohore të rregullta;
8. Të ju mundësohet studentëve që gjatë studimit të kryejnë së paku një kurs akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë, në një vend tjetër;
9. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të themelojë fond të posaqëm për përkrahjen e lëvizshmërisë së studentëve, gjegjësisht për zbatimin e plotë të ECTS (sidomos për të siguruar lëvizshmërinë e studentëve, e të tjera).

## 2. SUNDIMI I LIGJIT

### ***2.1 Luftimi i Korrupsionit: Si të bëhet më efektiv Agjencioni Anti-Korrupsion?***

*Autor:* Ramadan Ilazi, Lëvizja FOL

*Mirënjohje:* Bekim Kupina, Eli Gashi dhe Mentor Borovci

#### **Hyrje**

Ky punim përqendrohet në rolin e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit si institucioni kryesor administrativ për organizimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Edhe pse emri premtion shumë, performanca e këtij institucioni është brenga të cilën synon ta adresojë ky punim. Lufta kundër korrupsionit është çështje kyçe në integrimet euro-atlantike të Republikës së Kosovës dhe zbatimi i politikës së zero tolerancës ndaj korrupsionit është çështje kyçe në partneritetin evropian për Kosovën.

Ky punim trajton çështjet e funksionalitetit dhe pavarësisë së Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit (prej këtu e tutje i quajtur Agjencion ose AKK). Punimi propozon ndryshime konkrete në Ligjin kundër Korrupsionit, forcimin e pozitës së Agjencionit, në mënyrë që aranzhimet institucionale t'i mundësojnë Agjencionit të kontribuoj në mënyrë efektive në luftën aktuale kundër korrupsionit. Është me rëndësi të theksohet që gjatë bisedave me shoqërinë civile dhe atë politike, asnjëherë nuk vihet në dyshim nevoja për forcimin e agjencionit në luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, njerëzit e njejtë thërrasin për mbylljen e agjencionit për shkak të performancës aktuale.

Gjatë elaborimit të çështjeve të lartpërmendura, punimi trajton dy fusha të cilat ne mendojmë se janë kyçe: a) korniza legjislative e Agjencionit kundër Korrupsionit; b) marrëdhëniet e Agjencionit me institucionet e tjera kyçe, që lidhen drejtpërdrejt me çështjet e paanshmërisë, pavarësisë dhe transparencës së Agjencionit.

Pyetjet kyçe të cilat trajtohen në këtë punim janë: Si të bëhet Agjencioni plotësisht i pavarur dhe ta ndërtoj rolin e paraparë si trupi kryesor në luftën kundër korrupsionit? A do të ofrojë Agjencioni vetëm vetëdijesim publik apo do të jetë edhe akter aktiv në zvogëlimin e korrupsionit në institucionet publike? Si të organizohen marrëdhëniet në mes Agjencionit dhe institucioneve tjera shtetërore siç është Qeveria, Kuvendi dhe Zyra e Prokurorit në mënyrë të sigurohet pavarësia e Agjencionit në kuptim të burimeve, privilegjeve dhe autonomisë, dhe ta kryej punën e tij në mënyrë efektive? Derisa në këtë punim theksohen aspektet teknike të korrupsionit, vullneti politik për luftimin e



korupsionit mbetet parakusht kyç për sukses në këtë betejë të stërzgatur, ku institucionet mungojnë apo të paktën janë të paafta.

### **Agjencioni: Gjendja Aktuale**

Raportet e Progresit për Kosovën 2008 dhe 2009 të Komisionit European theksojnë se korupsioni ende ka shtrirje të gjerë dhe mbetet problem madhor për të gjitha institucionet shtetërore si dhe për pjesë të ndryshme të jetës shoqërore. Kjo ndodh për shkak të masave të pamjaftueshme legislative dhe zbatuese dhe mungesës së vendosmërisë dhe dobësisë së sistemit gjyqësor. Përveç kësaj, Komisioni European thekson që një raport i ri nga Zyra e Auditorit Gjeneral ka gjetur humbje të pashpjegueshme në buxhetin e Kosovës prej €0.5-5 milion në çdo ministri në vit. Një studim i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë thotë që 66% të bizneseve në Kosovë pranojnë që ryshfeti është i nevojshëm për të funksionuar në mënyrë efektive. Përveç kësaj, vlerësohet që ekonomia joformale përbën 38% të GDP-së së vendit tonë, dhe nëse e përkthejmë në terma monetar kjo do të thotë që më tepër se €1 miliard qarkullojnë dhe kontrollohen nga grupet kriminale pa u futur në sistemin e rregullt të ekonomisë sonë.

Transparency International, në raportin e saj periodik për Barometrin e Korupsionit, i jep Republikës së Kosovës notën 3.4 në nivelin e korupsionit (5 është nota më e lartë për korupsion). Sipas raportit, Kosova është vendi me më së paku korupsion në Ballkan, mirëpo, kjo është në kundërshtim me të dhënat e Raportit të Paralajmërimit të Hershëm të UNDP-së mbi perceptimin publik të korupsionit. Qysh para shpalljes së pavarësisë, prezenca ndërkombëtare në Kosovë ka pasur rol të madh në luftën kundër korupsionit, dhe disa kosovarë mendojnë që korupsioni ishte çmimi të cilin e paguan autoritetet ndërkombëtare për ta mbajtur stabilitetin e ndjeshëm në Kosovë. Një sfidë tjetër e luftës kundër korupsionit është perceptimi problematik publik i kuptimit aktual të korupsionit dhe i formave që mund të merr korupsioni. Në përgjithësi, korupsioni kuptohet si sinonim i ryshfetit; derisa publiku përjashton konfliktin e interesit dhe nepotizmin dhe nganjëherë raportimin e mediave kur bëhet fjalë për korupsionin.

Në vitin 2003, Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin kundër Korupsionit i cili ofron legjislacion afirmativ që mundëson luftën institucionale kundër korupsionit. Ligji rregullon dhe themelon Agjencionin Kosovar Kundër Korupsionit si institucion të pavarur i cili punon për ta parandaluar dhe luftuar korupsionin. Agjencioni zhvillon hetime administrative për veprime disiplinore ndaj shërbyesëve civil. Trupat publik, autoritetet lokale dhe personat zyrtar janë të detyruar me ligj t'i ofrojnë Agjencionit, sipas kërkesës së tij, të gjitha informatat e nevojshme për kryerjen e detyrave, dhe t'ia mundësojnë atij të inspektoj dokumentacionin relevant. Fondet për funksionimin e Agjencionit sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës sipas propozimit të Agjencionit. Agjencioni vendos mbi metodat për shfrytëzimin e fondeve. Megjithatë, kërkesa buxhetore së pari shkon në qeveri, dhe kjo e fundit pastaj e procedon kërkesën në Kuvend. Buxheti i miratuar për vitin 2008 ishte €456.600.00 dhe për vitin 2009 €495.484.00. Bazuar në një intervistë me një zyrtar të lartë të Agjencionit, në vitin 2007 qeveria nuk e ka përfshirë në buxhetin përfundimtar të dorëzuar në Kuvend kërkesën buxhetore të Agjencionit për rritjen e numrit të stafit. Kjo ka shkaktuar probleme me

zbatimin e detyrave të agjencionit. Ky është shembull konkret se si Agjencioni mund të ndikohet nëpërmjet procesit të buxhetimit.

Agjencioni menaxhohet nga drejtori i cili ka mandat pesëvjeçar dhe mund të rrimërohet një herë. Posti i drejtorit të Agjencionit nuk do të jetë ekuivalent me asnjë post tjetër në Qeveri, Kuvend, autoritete lokale, parti politike apo sindikata, apo të ketë ndonjë punë tjetër në organizatë publike lokale, ndërkombëtare apo supranacionale.

Këshilli i Agjencionit mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejt punën e Agjencionit. Këshilli poashtu inicion zgjedhjen e drejtorit të Agjencionit me anë të ftesës publike 6 muaj para skadimit të mandatit të drejtorit aktual. Këshilli ia propozon Kuvendit të Kosovës dy kandidatë për postin e drejtorit të Agjencionit, dhe Kuvendi pastaj duhet ta zgjedh njërin prej tyre. Këshilli i Agjencionit ka 9 anëtarë: 3 prej tyre emërohen nga Kuvendi dhe nga 1 anëtar e emërojnë: Zyra e Presidentit, Qeveria, Gjykata Supreme, Zyra e Prokurorit Publik, autoritetet lokale dhe shoqëria civile. Shpenzimet e anëtarëve që burojnë nga puna e tyre në Këshillin e Agjencionit mbulohe me skemën e kompensimit. Anëtarët e Këshillit të Agjencionit kanë mandat dyvjeçar dhe mund të rrimërohen.

### **Agjencioni në raport me institucionet e tjera**

Agjencioni ka ndërtuar bashkëpunim formal nëpërmjet memorandumeve të mirëkuptimit me Komisionin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, Qendrën e Inteligjencës Financiare, Kryesuesin e Prokurorëve të EULEX-it dhe me Ombudspersonin.

Ky punim konsideron që marrëdhënia në mes Agjencionit dhe Prokurorit Shtetëror është më e rëndësishme dhe në të njëjtën kohë më sfiduese. Raporti i Progresit për Kosovën 2009 i Komisionit European thekson bashkëpunimin e pamjaftueshëm në mes të Agjencionit dhe Zyrës së Prokurorit. Gjatë periudhës 2007-2008, Agjencioni kundër Korrupsionit ka dorëzuar më tepër se 100 raste në zyrën e Prokurorit por kjo e fundit ka reaguar në një numër shumë të vogël të tyre. Bazuar në faktet e ngritura në diskutimet rreth temës së këtij punimi, Prokuroria shpeshherë ia kthen prapa rastet me arsyetimin se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme. Ky arsyetim është retorikë politike për t'iu shmangur përgjegjësisë. Ky refuzim është indikator i marrëdhënieve të dobëta në mes këtyre dy agjencioneve të pavarura, i cili pastaj ndikon negativisht në luftën kundër korrupsionit. Gjatë Shtatorit të vitit 2008, Agjencioni kundër Korrupsionit ia dorëzoi 35 raste prokurorisë, e cila pastaj i inicioi disa procedura penale. Në fushën e konfliktit të interesit, Agjencioni ndërhyri në nëntë raste në periudhën Janar-Qershor 2008, dhe në katër raste tjera në periudhën Korrik-Shtator. Në Prill të vitit 2008, Agjencioni botoi listën e zyrtarëve që nuk i kishin deklaruar pasuritë e tyre. Në Gusht, Agjencioni iu kërkoi institucioneve që punësonin 17 zyrtarë, të cilët nuk e kishin deklaruar pasurinë e tyre, t'i fillojnë procedurat e shkarkimit.

Ndarja e përgjegjësisë në mes Agjencionit kundër Korrupsionit dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë, kryesuesi i së cilës është zëvendës udhëheqës i Këshillit Anti-Korrupsion, ka shkaktuar çarje. Bashkëpunimi me Zyrën e Ombudspersonit mbetet i dobët. Niveli i trajnimeve që ofrohen për zyrat e prokurimit të ministrive nuk është i njëjtë.

Një institucion tjetër i rëndësishëm për bashkëpunim me Agjencionin është Policia e Kosovës. Derisa agjencioni është bërë plotësisht funksional dhe i pajisur me kuadro në vitin 2009, Policia ka përkrahjen e nevojshme teknike të zhvilloj hulumtime dhe hetime më të mira rreth korrupsionit. Marrëdhënia e Agjencionit me këtë institucion mbetet e dobët.

Fushëveprimi i menduar i bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të Agjencionit dhe Zyrës së Ombudspersonit mbetet i paqartë. Ombudspersoni harton raport vjetor i cili përmban informata për rastet e dyshuara të korrupsionit në administratë publike; megjithatë, Agjencioni ka treguar performancë të dobët gjatë shfrytëzimit të tyre si bazë për hetime të mëtutjeshme. Bashkëpunimi i Agjencionit me Auditorin Gjeneral është poashtu i mjegullt. Auditori Gjeneral boton raportin vjetor të auditimit i cili përmban shumë shënime për raste të korrupsionit dhe abuzimit të pushtetit.

### **Sfida e paanshmërisë dhe pavarësisë**

Paanshmëria dhe pavarësia e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit janë kryesore për suksesin e tij. Si rezultat i mungesës së vullnetit të mjaftueshëm politik për luftimin e korrupsionit dhe për shkak të sistemit të dobët të drejtësisë dhe dështimit të prokurorisë, puna e Agjencionit në shumicën e rasteve përfshin vetëm një raport të mirë. Agjencioni nuk gëzon përkrahjen e nevojshme politike dhe financiare për zbatimin e mandatit të tij. Rrogat dhe buxheti i përgjithshëm operacional i agjencionit janë shumë të vogla. Kjo ndikon edhe në performancën e zyrtarëve të Agjencionit. Puna dhe detyrat e tyre përfshijnë nivel të caktuar të rrezikut dhe prandaj ata kanë nevojë për përkrahje më të fuqishme.

Suksesi final i punës së agjencionit varet shumë nga reagimi i institucioneve të tjera: policia, prokuroria dhe gjykatat. Në Letoni për shembull, agjencioni kundër korrupsionit e ka njësinë e vet policore dhe qendrën e paraburgimit. Duhet të shqyrtohet mundësia e forcimit dhe zgjerimit të mandatit të Agjencionit. Gjatë diskutimeve duhet të shqyrtohet edhe mundësia që Agjencioni ta ketë autoritetin për arrestimin dhe paraburgimin e individëve të dyshuar për korrupsion.

Në rastin e Kosovës, emri Agjencion Kundër Korrupsionit krijon perceptim të ndryshëm nga roli i tij aktual. Në këtë kontekst, autoriteti i Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit nuk përkon plotësisht me emrin e institucionit. Perceptimi publik për punën e këtij institucioni orientohet nga vet emri i organizatës duke krijuar kështu huti në mesin e publikut për rolin dhe funksionet e vërteta të agjencionit. Pritjet janë të madhe, megjithatë, agjencioni nuk mund të bëjë shumë pa përkrahjen dhe bashkërendimin e nevojshëm me institucionet tjera.

Një komponent tjetër i cili paraqet potencial për ndërhyrje në pavarësinë e agjencionit është Neni 23 (c) i cili thotë që Agjencioni "e përgatit strategjinë anti-korrupsion për Qeverinë dhe për miratim nga Kuvendi dhe është përgjegjës për ndryshime dhe për

zbatimim e saj". Fakti që qeveria duhet ta miratoj strategjinë anti-korrupsion dhe vet procesin paraqet potencial për ndërhyrje nga qeveria në strategji.

## **Konkludime dhe Rekomandime**

Rekomandimet dhe konkludimet në vijim janë bërë duke marrë parasysh kapacitetin e institucioneve që t'i përmbushin ato. Rekomandimet kryesisht propozojnë ndryshime që mund të ofrojnë pavarësi më të madhe politike të Agjencionit duke siguruar kështu luftë efikase kundër korrupsionit.

1. *Forcimi i pavarësisë së Agjencionit dhe zvogëlimi i mundësisë për ndërhyrje (kontroll) direkt të Qeverisë në punën e Agjencionit:*
  - A) Ligji përcakton rol administrativ dhe monitorues për Agjencionin dhe ky i fundit vepron vetëm si ndërmjetësues në mes trupave publik dhe zyrës së prokurorit. Në Nenin 16 të Ligjit thuhet se Agjencioni do t'i procedojë për shqyrtim të gjitha rastet e korrupsionit tek Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës. Përderisa kjo nuk paraqet ndonjë problem, Ligji kundër Korrupsionit duhet ta zgjeroj dhe forcoj autoritetin e Agjencionit në fushën e hetimeve.
  - B) Të ndryshohen dispozitat e Ligjit për çështjet e pasurisë dhe asetëve të zyrtarëve publik, si dhe për rastet e konfliktit të interesit.
  - C) Të shpërndahet Këshilli i Agjencionit për të mundësuar efikasitet më të madh dhe kontroll më të vogël të qeverive dhe partive politike mbi Agjencionin.
  - D) Procesi i buxhetimit nuk duhet të kaloj nëpër qeveri. Ligji kundër Korrupsionit dhe Ligji për Financat Publike duhet të ndryshohen për agjencionet e pavarura në mënyrë që procesi i buxhetimit të ketë qasje dhe marrëdhënie të drejtpërdrejta me Kuvendin, e jo nëpërmjet Qeverisë.
  - E) Neni 23 (c) duhet të ndryshohet ashtu që Strategjia kundër Korrupsionit të mos duhet të miratohet nga qeveria para se të procedohet në Parlament. Agjencioni duhet të jetë në gjendje të shkojë në Parlament për ta konfirmuar Strategjinë.
1. *Të përmirësohet ndërveprimi në mes Agjencionit dhe Kuvendit:*
  - A) Zyrtarët e Agjencionit duhet të marrin rol aktiv në takimet e komisioneve parlamentare posaçërisht në çështjet që i takojnë profilit të Agjencionit.
  - B) Kuvendi duhet ta zgjas mandatin e komisionit ekzistues parlamentar për ta mbuluar punën e agjencionit.
2. *Të përmirësohet ndërveprimi i Agjencionit dhe reagimi ndaj punës së institucioneve tjera, duke i lidhur kështu përpjekjet në luftën kundër korrupsionit:*
  - A) Në bazë të raportit të Ombudspersonit, Agjencioni duhet të zhvillojë hetime të mëtutjeshme duke krijuar kështu besimin e publikut ndaj Agjencionit.
  - B) Raportet e Auditorit Gjeneral duhet të shoqërohen me hetime administrative nga Agjencioni duke i bërë presion kështu prokurorit që t'i marrë parasysh të gjeturat.
  - C) Shpallja publike e vlerësimeve dhe informatave statistikore për marrëdhëniet në mes Zyrës së Ombudspersonit dhe institucioneve të Auditorit Gjeneral.

3. *Agjencioni ka nevojë për strategji më të mirë për transparencë dhe marrëdhënie me publikun:*

A) Promovimi më i madh i rezultateve të punës dhe sukseseve të saj.

B) Forcimi i kapaciteteve të saj në fushën e hulumtimeve; duke i përmirësuar kështu konsultimet dhe duke lëshuar statistika dhe raporte në fushën e luftës kundër korrupsionit.

C) Hartimi i raporteve studimore për zbatimin e Ligjit kundër Korrupsionit.

*Burimet:*

Raportet e Progresit për Kosovën 2008 dhe 2009 të Komisionit European  
Ligji kundër Korrupsionit

## ***2.2 Financimi i Partive Politike: Nevoja për një ligj të vetëm***

*Autor:* Merita Mustafa dhe Besnik Ramadanaj  
Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

*Mirënjohje:* Armend Zemaj, LDK; Bahri Hyseni, PDK; Sejdë Tolaj, LDD; Petrit Zogaj, Lëvizja FOL ; Arban Abrashi, LDK; Fehmi Ajvazi, KQZ; Ardian Gjini, AAK; Ismet Kryeziu, KDI; Driton Selmanaj, KDI.

### **Hyrje**

Partitë politike formojnë një pjesë të fuqishme të shoqërive demokratike si përfaqësuese të popullit. Megjithatë, para se të ligjërojnë për promovimin e demokracisë në nivelet e ndryshme të jetës shoqërore, politikanët duhet të sigurojnë transparencë dhe llogaridhënie në mesin e tyre. Partitë politike në Kosovë shpeshherë pohojnë që luftojnë për transparencë në nivelin qeveritar, mirëpo në të njëjtën kohë ato nuk i trajtojnë këto çështje brenda strukturave të tyre. Partitë mbesin të mbyllura për publikun e gjerë dhe shpeshherë operojnë në mënyrë të panjohur. Demokratizimi i brendshëm dhe funksionimi më transparent i partive politike pa dyshim do ta rriste besimin e publikut në punën e tyre dhe do të inkurajonte pjesëmarrje më të gjerë të qytetarëve.

Pa e vënë në dyshim të drejtën e partive politike për mbledhjen e fondeve përveç atyre që iu caktohen nga buxheti shtetëror, siç ndodh në vendet e tjera demokratike evropiane, ne mendojmë që procesi i mbledhjes së fondeve duhet të bëhet në mënyrë transparente. Fatkeqësisht, korniza aktuale ligjore hutuese në Kosovë iu mundëson partive politike të veprojnë pa caktuar standarde dhe rregulla të qarta. Rreziku i varësisë nga një donator është poaq i rrezikshëm sa marrëdhënia e ngushtë në mes donatorëve dhe politikanëve. Rregullat e qarta janë të rëndësishme për parandalimin e konfliktit të interesit dhe korrupsionit brenda strukturave partiake, të cilat poashtu kanë ndikim në punën qeveritare dhe parlamentare të anëtarëve të partive.

Hap i pashmangshëm për sigurimin e llogaridhënies nga përfaqësuesit tonë të zgjedhur është futja në fuqi e kornizës ligjore e cila do të caktonte kufinjë të qartë sipas të cilëve partitë politike do ta financonin punën e tyre të përditshme dhe fushatat zgjedhore. Korniza e qëndrueshme ligjore do të siguronte që partitë politike duhet të japin llogari për performancën e tyre financiare.

Financimi i partive politike në Kosovë vazhdon të jetë temë tabu për të gjitha partitë politike, qoftë atyre në pushtet ashtu edhe atyre në opozitë. Kjo është poashtu arsyeja pse dhjetë vite pas luftës dhe një vit pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, vendi ynë ende nuk e ka rregulluar në mënyrë të plotë financimin e partive politike.

Është menduar se draft-ligji për Financimin e Partive Politike, i sponsoruar nga Zyra e Kryeministrit, do ta zgjidh problemin e lartpërmendur. Edhe pse është pritur që Ligji do të miratohet në maj të vitit 2009, Ligji i është proceduar Kuvendit në muajin tetor.

*Nëpërmjet rekomandimeve të ofruara në këtë punim, ne synojmë:*

- të bëhet presion mbi mekanizmat shtetërorë që ta miratojnë Ligjin për financimin e partive politike, nëpërmjet të cilit do të krijohen mekanizmat adekuat që sigurojnë transparencë mbi prejardhjen dhe menaxhimin e fondeve
- të kontribuohet në sjellje më të përgjegjshme të institucioneve që e hartojnë dhe miratojnë Ligjin
- të propozohen dispozita konkrete të cilat do të përfshihen në versionin përfundimtar të dokumentit.

### **Korniza aktuale hutuese dhe e pamjaftueshme ligjore**

Në përgjithësi, partitë politike në Kosovë vuajnë nga probleme organizative, nga mungesa e strategjive politike dhe përqendrimi në projekte afatshkurta dhe nuk kanë vizion apo profil të definuar ideologjik. Përveç kësaj, atyre iu mungon transparenca në financim, që është çështje kyçe për demokratizimin e skenës politike në Kosovë dhe shoqërisë në përgjithësi.

Në vitin 2004, Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për Financimin e Partive Politike, për Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) refuzoi ta nënshkruajë atë. Pesë vite më vonë, partitë politike ende financohen nga burime private pa rregulla të qarta të caktuara me ligj. Ky vakum ligjor krijon mundësi për abuzimin e burimeve financiare dhe e zvogëlon nivelin e llogaridhënies nga partitë politike.

Problemet lidhur me përgatitjen dhe miratimin e Ligjit në qeveri u shkaktuan nga nevoja për të inkorporuar disa rekomandime kyçe të Këshillit të Evropës sipas principeve në vijim: balanci i arsyeshëm në mes financimit publik dhe privat, kriteret korrekte për ndarjen e kontributeve shtetërore për partitë politike, rregullat strikte për donacione private, pragu i shpenzimeve të partive politike gjatë fushatave të tyre zgjedhor, transparencë e plotë për llogaritë, themelimi i autoritetit të pavarur të auditimit dhe sanksione kuptimplota për rastet e shkeljes së ligjit.

Financimi i partive politike edhe më tutje rregullohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/11 dhe me Ligjet për Zgjedhje të Përgjithshme dhe Zgjedhje Lokale, të miratuara në vitin 2008. Megjithatë, ka kontradikta serioze në mes rregulloreve të UNMIK-ut dhe legjislacionit të miratuar pas shpalljes së pavarësisë.

Kapitulli i 6 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme parasheh “Kufirin shpenzues dhe hapjen financiare të fushatës”, ndërsa Neni 39 cakton obligimin e partive politike dhe maksimumin e kostove të lejuara. Megjithatë, ligji nuk definon llojin e donatorëve prej të cilëve partitë politike mund të marrin kontribute. Ndërkohë, Neni 40 cakton afatin përfundimtar për dorëzimin e raporteve financiare të fushatave zgjedhore. Ky nen poashtu thotë që të gjitha kostot që e tejkalojnë shumën prej €100 duhet të kenë fakturë.

Disa përfaqësues të partive politike që morën pjesë në punëtorinë e KDI-së në Maj të vitit 2009 pranuan që ky obligim nuk është respektuar gjithmonë. Sa i përket auditimit, Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) është aktualisht përgjegjës për emërimin e auditorit. Neni 42 i këtij Ligji poashtu rregullon sanksione kundër shkeljeve të ligjit. Sipas Nenit 39, partitë mund ta shfrytëzojnë të drejtën e ankesës.

Mungesa e kornizës adekuate ligjore e ul llogaridhënien e partive politike ndaj qytetarëve dhe prandaj lë dritare të hapur për abuzimet financiare të partive politike. Vonesat e Qeverisë për ta përgatitur dhe dorëzuar Ligjin për financimin e partive politike zgjon dyshime që partitë politike e shfrytëzojnë vakumin ligjor për keqpërdorim të fondeve apo për fitime personale.

### **Rregullat që duhet zbatuar për financimin e partive**

Në punëtorinë e organizuar nga KDI-ja më 6 Maj 2009 ku morën pjesë anëtarë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues të partive politike, ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, shumë pjesëmarrës konfirmuan që gjendja aktuale kërkon miratimin urgjent të një ligji të vetëm i cili në mënyrë përmbytëse do ta rregullojë financimin e partive politike. Ligji do t'i definonte në mënyrë të qartë: prejardhjen e fondeve, kufinjët e shpenzimeve, pagesat e kuadrove të partive, si dhe shpenzimin e fondeve të alokuara nga Buxheti i Kosovës. Pjesëmarrësit poashtu shprehën nevojën për kufizimin e shpenzimeve financiare të partive politike dhe për ndërprerjen e dhënies së fondeve shtetërore për fushatat zgjedhore të partive politike. Ata propozuan që donacionet private duhet të miratohen dhe kufizohen me ligj. Zyra e Auditorit Gjeneral duhet ta bëjë auditimin e pavarur të performancës së partive politike.

Krijimi i pragut adekuat për shpenzimet e partive politike dhe rregullimi i pagave dhe obligimeve të kuadrove të partive do të krijonte hapësirë për menaxhim më të mirë të buxheteve partiake dhe do ta zvogëlonte mundësinë e shmangies nga obligimet ligjore.

Baza ligjore do të krijonte mundësi që partitë politike të investojnë në patundshmëri dhe në iniciativa tjera me karakter joprofitabil. Këto investime do t'iu mundësonin partive të bëhen të vetëqëndrueshme dhe të zhvillohen më tutje. Investimet do të duhej të kenë karakter joprofitabil, siç janë zyrat e partive, veturat, mediat elektronike dhe të shtypura, fondacionet, institucionet që merren me analiza hulumtuese, botime, etj.

Një element tjetër i rëndësishëm është mundësia e futjes së principit të barazisë në mes partive politike sa i përket disponueshmërisë së fondeve. Financimi i partive politike sugjerohet të përbëhet nga disa burime: buxheti shtetëror, që përfshin taksat e qytetarëve; donacionet e individëve dhe personave ligjor; tarifat e anëtarësimi; dhe produktet të cilat partitë politike i lançojnë në treg të hapur. Kjo do ta mundësonte zhvillimin e partive politike, qëndrueshmërinë financiare dhe do ta zvogëlonte rrezikun e varësisë nga një burim i vetëm i financimit. Përfshirja e këtyre elementeve të financimit, do të shmange varësinë e partive politike nga grupet e interesit. Për shkak të numrit të madh të kosovarëve që jetojnë në vende të jashtme, Ligji duhet të vlej edhe për partitë që financohen nga individë dhe persona ligjorë që jetojnë jashtë Kosovës.



Për ta shmangur çdo rrezik ndaj partive politike dhe zhvillimit të tyre, posaçërisht të partive të reja apo të vogla, financimi duhet të kalkulohet sipas numrit të votave që fitohen në zgjedhje dhe jo sipas numrit të ulëseve në parlament. Shumat e alokuara për partitë politike nga buxheti shtetëror nuk duhet ta kalojnë shumën mesatare për alokime të ngjashme në vendet e Bashkimit Europian.

Poashtu ekziston nevoja për ndryshimin e praktikës së financimit parlamentar të partive politike, i ashtuquajtur i buxhet për demokratizim. Partitë politike duhet të financohen vetëm nga buxheti i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe jo nga buxheti i Kuvendit. Kjo do të mundësonte forcimin e jo vetëm partive politike që kanë numër të konsiderueshëm të votave por edhe të atyre që nuk kanë arritur ta kalojnë pragun zgjedhor.

Sa i përket obligimeve dhe kushteve të drejtpërdrejta të partive politike, ligji do t'i rregulloj pagat – kontributet – taksat e stafit politik dhe tarifën për ekspertët që punojnë brenda partive politike. Degët e partive politike do të kenë xhirrollogari bankare si dhe do të mbajnë përgjegjësi (kryesuesi, sekretari) për ato që duhen sanksionuar dhe kufizuar. Në ndërkohë, për ta forcuar barazinë në mes të partive politike, pragu për tarifën e anëtarësimit duhet të përcaktohet me ligj. Shuma më e madhe të cilën e marrin partitë politike nuk duhet ta kalojë një euro për një anëtar.

Një alternativë tjetër e rregulluar me ligj për financimin e partive politike mund të jetë financimi nëpërmjet produkteve të cilat partitë i ofrojnë për shitje. Këto mund të jenë botime apo hulumtime të cilat partitë politike kanë të drejtë t'i shesin.

Avancimi i transparencës dhe llogaridhënies së partive politike për mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve besohet të jetë element kyç në kontekst të ligjit. Në këtë drejtim, lista e donatorëve të partive politike duhet të jetë publike. Individët, personat ligjor apo anëtarët duhet të mbushin formularët e financimit, të cilët përmbajnë të dhëna për shumën, emrin, mbiemrin, numrin e letërnjoftimit, adresën dhe kontakt personin. Nëse nuk veprojnë kështu, partitë politike nuk do të demonstrojnë transparencë në raport me shtetin dhe qytetarët. Për të qenë më transparent, financimi duhet të bëhet nëpërmjet transaksioneve bankare. Donatorët natyral dhe ligjor duhet t'i bëjnë transaksionet nëpërmjet bankës. Vlera e donacioneve që lejohen, përveç se me transaksion bankar, nuk duhet ta kalojë shumën prej €100.

Një element tjetër i cili duhet të merret parasysh në këtë Ligj është shmangia e keqpërdorimit të fondeve nga ana e partive politike gjatë fushatave nëpërmjet caktimit të kufinjëve shpenzues dhe ku mund të caktohet shuma (varësisht nga numri i votave) të cilën mund ta shpenzojnë partitë.

## **Zbatimi i Ligjit dhe mekanizmat e kontrollit**

Hartimi dhe botimi i buxhetit vjetor është segmenti tjetër i rëndësishëm. Partitë politike duhet të botojnë raporte financiare dhe t'i vënë ato në dispozicion të publikut dhe jo më vonë se tre muaj pas fundit të vitit kalendarik. Këto raporte duhet të botohen në uebfaqet e partive politike. KQZ-ja mban përgjegjësinë për botimin e raporteve financiare për ato parti politike që nuk kanë uebfaqe. Nëse nuk ndodh kjo, qytetarët nuk do të kenë qasje në raportet financiare të partive politike dhe kjo do të krijonte përshtypje të dyshimit rreth financimit dhe aktiviteteve të partive politike.

Çdo ligj duhet të zbatohet, por një element i rëndësishëm janë sanksionet në rast të shkeljeve të ligjit. Në mënyrë që kjo të ketë sukses, financat e partive politike duhet t'i nënshtrohen auditimit të jashtëm. Partitë politike duhet të demonstrojnë vullnet, gatishmëri dhe respektim të ligjit për të lejuar qasje dhe për të lejuar mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të auditimit të pavarur të jashtëm të financave të partive politike. Kjo do ta shmangte manipulimin e partive politike nëpërmjet financimit.

Sa i përket sanksioneve, mekanizmat që krijojnë mundësi të gjobitjes dhe ndjekjes penale duhet të caktohen qartë në ato raste kur personat natyral/ligjor i japin donacione partive apo zyrtarëve politik dhe ata të cilët i pranojnë fondet në emër të partive politike e shkelin ligjin. Kjo do ta zvogëlonte mundësinë e keqpërdorimit me anë të mjeteve financiare.

Poashtu duhet të kemi parasysh që Ligji do të mundësojë transparencë të plotë për financimin e partive politike; dhe nëse fondet e partive politike bëhen publike, atëherë duhet të themelohen mekanizma të fuqishëm për mbikëqyrjen e këtyre financave. Përveç kësaj, duhet të parashihet raportimi i rregullt financiar i partive politike.

## **Konkludime**

Gjetja më e evidente në këtë analizë është mungesa e përkushtimit politik nga ana e institucioneve për ta miratuar ligjin sa më shpejt që është e mundur. Në muajin Nëntor të këtij viti, zgjedhjet lokale do të mbahen në bazë të premtimit që autoritetet përgjegjëse do ta përgatisin Ligjin për Financimin e Partive Politike para zgjedhjeve.

Tash, disa muaj para zgjedhjeve lokale, të planifikuara për 15 Nëntor, partitë politike rrezikojnë të futën edhe një herë në lojë dhe këtë herë pa një ligj i cili i definon mënyrat e financimit. Nivelet më të larta të qeverisë premtojnë që ligji do të jetë gati para zgjedhjeve. Por, marrë parasysh progresin në këtë drejtim si dhe informatat nga zyra ligjore e Kryeministrit që është përgjegjëse për hartimin e ligjit, është vështirë të besohet se ligji do të hartohet para fundit të vitit.

Përmbajtja e ligjit duhet të jetë në përputhje me standardet demokratike dhe me rekomandimet e Këshillit të Evropës. Ligji poashtu duhet të përfshijë interesat e të gjitha partive politike në mënyrë që të ketë përmbajtje të gjerë si dhe të përfaqësojë edhe interesat e partive të komuniteteve pakicë. Një element kyç i cili duhet të shqyrtohet është

që Ligji për Financimin e Partive Politike të ofrojë hapësirë të mjaftueshme për transparencë dhe llogaridhënie në fushën e financimit të partive politike.

Përmbushja e këtyre objektivave mund ta rregulloj çështjen e financimit të partive politike bazuar në norma ligjore dhe standarde demokratike. Duke e parë rëndësinë e ligjit si demonstrim të vullnetit politik dhe të luftës ligjore kundër korrupsionit, Kuvendi, Qeveria dhe partitë politike, nëse përkushtohen për hartimin dhe miratimin e ligjit, do të demonstronjë vullnet politik për zbatimin e ligjit dhe luftimin e korrupsionit. Ligji për financimin e partive politike krijon mekanizma që zvogëlojnë mundësinë e lidhjes së partive politike me fenomene korruptive. Në mungesë të ligjit në fjalë, ekziston mundësia që partitë politike t'i keqpërdorin fondet.

Zyra Ligjore e Kryeministrit, si sponsoruese e këtij Ligji, Komisionet Parlamentare dhe Kuvendi i Kosovës duhet ta ndjekin agjendën legjislativë dhe duhet ta vendosin si prioritet hartimin dhe miratimin e ligjit për financimin e partive politike. Kuvendi i Kosovës duhet të angazhohet për t'u siguruar që ligji është në harmoni, dhe pa krijuar kundërtënie në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, me Ligjin për Financa Publike, Ligjin për Zgjedhje dhe Ligjin për Auditim. Përveç kësaj, ligji duhet poashtu të jetë në përputhje me legjislacionin europian.

Për të qenë më i pranueshëm dhe për të shkëmbyer njohuri dhe përvoja, do të ishte jashtëzakonisht e dobishme të përfshihen akterë të gjerë relevant. Në këtë segment, duhet të organizohen hulumtime dhe dëgjime publike. Shqyrtimi i këtyre elementeve do ta rriste kredibilitetin të qytetarët, do të zvogëlonte mundësinë e keqpërdorimit, do ta përmirësonte performancën e institucioneve, dhe do ta përshpejtonte procesin e integritetit në Bashkimin Europian.

Përfshirja e këtyre elementeve do të ndikojë në rritjen e transparencës së financimit të partive politike, kufizimin e shpenzimeve, dhe do ta zvogëlonte mundësinë e shmangies nga obligimet ligjore. Kjo politikë poashtu do të ndikojë në uljen e keqpërdorimeve, në rritjen dhe qëndrueshmërinë e partive politike, si dhe në rritjen e kredibilitetit të aktiviteteve të partive politike ndaj opinionit publik.

Nëse e marrin parasysh këtë punim, institucionet përgjegjëse do të kenë mundësi të gjejnë përgjigje reale në përputhje me kërkesat demokratike të cilat do ta bënin ligjin të pranueshëm dhe të zbatueshëm.

*Burimet:*

Diskutimet në punëtorinë e KDI-së – Maj, Qershor 2009

Rregullorja e UNMIK-ut 2004/11

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme

Ligji për Zgjedhjet Lokale

### **3. EKONOMIA**

#### ***3.1 A jemi të gatshëm t'i privatizojmë ndërmarrjet publike?***

*Autor:* Alban Zogaj, Instituti RIINVEST

#### **Hyrje**

Pa marrë parasysh përvojën e përzier dhe vlerësimin e dobët të mësimave nga privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore që nga viti 2003, qeveria tashmë ka hartuar plane për privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha strategjike që ende gjenden në duart e saj. Ky privatizim i "madh" duhet të përfshijë pjesë të Korporatës Energjetike të Kosovës, Postës dhe Telekomit të Kosovës, si dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Në një rën anë ekziston konsensus në opinionin e gjerë dhe grupet e interesit rreth nevojës për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, në anën tjetër ka brenga për mungesën e strategjive dhe planifikimit adekuat të privatizimit në mënyrë që të arrihen përfitime maksimale për shoqërinë kosovare.

Në këtë drejtim, ky punim do të përqendrohet në metodat alternative të privatizimit e jo në vet procesin e privatizimit meqë arsytet e privatizimit janë të qarta: simbol politik i reformës dhe trajtimi i mosefikasitetit në sektorin shtetëror. Përveç kësaj, punimi poashtu do t'i shqyrtoj praktikatat më të mira në rajon dhe se si duhet të veprojnë qeveritë para se ta vazhdojnë procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Publike dhe nëse ka mekanizma të qartë ligjorë për vazhdimin e këtij procesi? Pyetjet kryesore të cilat i adreson ky punim janë: Si duhet të bëhet privatizimi i Ndërmarrjeve Publike? A është tani koha e duhur për privatizimin e "madh"? Cilat procedura duhet ndjekur? A jemi të gatshëm – sa i përket kornizës ligjore dhe obligimeve pas privatizimit – t'i privatizojmë ndërmarrjet publike?

#### **Mësimet e nxjerra nga privatizimi në Kosovë**

Privatizimi ka qenë komponent i rëndësishëm i reformës ekonomike dhe sociale në ekonominë në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore në dy dekadat e fundit. Kosova ka trashëguar trashëgiminë jugosllave të sistemit vetmenaxhues dhe procesin e privatizimit të lancuar në vitin 1989 nga qeveria e Ante Markoviqit. Megjithatë, në Kosovë, vetëm një numër tejet i vogël i ndërmarrjeve ia dolën të futen në skemën e privatizimit meqë procesi u ndërpre shumë shpejt kur Qeveria e Serbisë zbatoi masa të jashtëzakonshme në Kosovë në Mars të vitit 1989. Procesin e privatizimit filloi përsëri pas vitit 1999, nën patronazhin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM) e cila u themelua në vitin 2002 nën ombrellën e Shtyllës së Katërt të BE-së, pjesë e Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Pas shpalljes së pavarësisë, AKM-ja u

transformua në Agjencionin Kosovar të Privatizimit (AKP) me Ligjin Nr. 03/L-067 dhe operon si trup i pavarur publik.

Para vitit 1989, pothuajse të gjitha aktivitetet ekonomike në Kosovë zbatoheshin nga Ndërmarrjet Shoqërore, dhe vetëm sektorët strategjik ishin "pronë publike", që mund të njihen edhe si "ndërmarrje të mëdha shtetërore". Edhe pse privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore filloi në vitin 2003, pas shtatë viteve ky proces është akoma në gjysmë të rrugës. Nga rreth 500 ndërmarrje shoqërore në Kosovë (ky numër është i përafërt për shkak të paqartësive rreth definimit ligjor të "pronësisë shoqërore" si dhe dokumentacionit të humbur një pjesë dërrmuese e të cilit u shkatërrua gjatë luftës së vitit 1999), deri më tani janë privatizuar më tepër se gjysma e tyre. Rreth 450 ndërmarrje posedojnë dokumentacion i cili tregon qartë statusin e pronësisë shoqërore, përderisa statusi i ndërmarrjeve tjera mbetet i paqartë. Përveç raportit për mësimet e nxjerra nga procesi i privatizimit, i botuar në vitin 2008 nga Instituti Riinvest, nuk ka analiza tjera përmbajtjesore për procesin e privatizimitin e as vlerësime serioze për ndikimin e privatizimit në performancën e ndërmarrjeve në Kosovë. Raporti i Institutit Riinvest e pasqyron procesin e privatizimit si "gotë gjysmë të zbrazët ose gjysmë të mbushur", varësisht nga perceptimet e grupeve të ndryshme të interesit. Studimi tregoi që rreth një e treta e ndërmarrjeve të privatizuara e kanë vazhduar biznesin e tyre të mëparshëm, derisa dy e treta e tyre e kanë ndryshuar natyrën e aktiviteteve apo nuk merren fare më me biznes. Numri i madh i ndërmarrjeve të privatizuara joaktive, fenomen ky i cili nuk është i rëndomtë në ekonomitë tjera në tranzicion, mbetet brengë alarmuese për procesin e privatizimit në Kosovë.

Në këtë pamje të përzier të rezultateve dhe përvojës me procesin e privatizimit të NSH-ve në Kosovë, Qeveria e Kosovës shprehu përkushtimin e saj për privatizimin e Ndërmarrjeve Publike (NP) në fillim të vitit 2009. NP-të në Kosovë përfshijnë shërbimet publike (energjinë elektrike, telekomunikacionin dhe furnizimin me ujë), transportin hekurudhor, terminalin e aeroportit dhe disa ndërmarrje tjera të vogla që ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizimit kryesisht në nivelin komunal. Bazuar në intervistën me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, vendimi i Qeverisë së Kosovës për përfshirjen e sektorit privat në shërbimet publike (energji elektrike dhe telekomunikacion) është i nevojshëm dhe ndoshta vjen tepër vonë siç tregojnë edhe rezultatet e menaxhimit joefikas dhe skandalet e korrupsionit në ndërmarrjet strategjike. Privatizimi i "ri" duhet të përfshij pjesë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK), Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) dhe disa aranzhime të koncesionit për minierat.

KEK-u dhe PTK-ja janë punëdhënësit më të mëdhenj në Kosovë, dhe vetëm KEK-u ka rreth 8000 nëpunës. Këto ndërmarrje kanë ndikim të fuqishëm në performancën e sektorëve të tjerë ekonomik meqë ofrojnë shërbime kyçe siç është furnizimi me energji elektrike. Ato poashtu kanë ndikim në mirëqenien e qytetarëve në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet shërbimeve bazike. Prandaj, çdo përmirësim i performancës së këtyre ndërmarrjeve të mëdha do të ketë ndikim pozitiv në gjendjen e përgjithshme ekonomike dhe sociale.

Aktualisht, ndërmarrjet strategjike ballafaqohen me mangësi në menaxhim dhe disa prej tyre tashmë kanë vështirësi serioze financiare. Për disa vite me radhë, Raporti i Paralajmërimit të Hershëm i UNDP-së, i ka renditur këto ndërmarrje në majën e listës së ndërmarrjeve të prekura nga korrupsioni. Publiku i gjerë është i njohur me skandalet e korrupsionit që shoqërojnë çdo hapje të tenderit nga çdo ndërmarrje publike. Probleme tjera serioze shfaqen në procedurat e paqarta të punësimit (ndërmarrjet publike në Kosovë kanë numër të tepërt të nëpunësve dhe si rrjedhojë nuk janë efikase) dhe skemat zemërgjera të menaxhimit të kompensimit. Kjo gjendje krijon konsensus të gjerë në mesin e të gjitha grupeve të interesit dhe shoqërisë për nevojën e pashmangshme të privatizimit të NP-ve. Megjithatë, akoma ka brenga për kohën më të përshtatshme dhe për rregulla dhe procedura të qarta e transparente.

### **Dizajnimi i privatizimit të NP-ve**

Ligji për Ndërmarrjet Publike në Republikën e Kosovës, i cili hyri në fuqi më 15 Qershor 2008, themelon kornizë të re rregullative për NP-të, duke i vënë ato nën autoritetin e Qeverisë së Kosovës (NP-të qendrore) apo të komunave (NP-të lokale). Ndërmarrjet e mëdha strategjike që operojnë në mbarë Kosovën që planifikohen të privatizohen janë në pronësi të Republikës së Kosovës, e cila aktualisht ka 100% të aksioneve në pronësi të qeverisë. Aksionet e qeverisë në çdo NP mund të shiten nëse Qeveria miraton vendimin për autorizimin e Komisionit Qeveritar të Privatizimit<sup>20</sup> të procedojë me tenderimin dhe shitjen e aksioneve. Kur vendimi i qeverisë të miratohet nga Kuvendi i Kosovës (me shumicë të thjeshtë votash), Komisioni procedon me hapjen e tenderëve dhe shitjen e aksioneve.

Gjendja e NP-ve në Kosovë që planifikohet të privatizohen dallon dukshëm në shumë aspekte. PTK-ja, në njërin anë, përkundër historisë së gjatë të skandaleve financiare, është aktualisht ndërmarrja më profitabile publike në Kosovë. Të ardhurat e kësaj ndërmarrjeje u rritën më tepër se 46 përqind në periudhën 2002-2006, dhe profiti i saj operativ u rrit për 148 përqind gjatë përqindjes së njëjtë. KEK-u, në anën tjetër, për shkak të kapacitetit të ulët të faturimit dhe problemeve serioze teknike, vazhdon të operoj me humbje financiare dhe varet nga subvencione të rregullta nga buxheti shtetëror. Në periudhat 2005 dhe 2006, KEK-u faturoi vetëm 52 përqind të energjisë së distribuuar dhe mblodhi vetëm dy të tretat të shumës së faturuar, p.sh. vetëm 35 përqind të energjisë elektrike të distribuuar.

Në anën tjetër, KOSTT-i, ndërmarrje e ndërtuar rishtazi gjatë procesit të ndarjes së KEK-ut, ka pasur performancë pozitive në vitet 2006 dhe 2007. Aeroporti i Prishtinës poashtu ka treguar trende pozitive me ç'rast vlera e asetëve u rrit për 44.6 përqind gjatë periudhës 2002-2006.

---

<sup>20</sup> Çdo Komision Qeveritar për Privatizim do të përbëhet nga pesë anëtarë: Ministri i Ekonomisë dhe Financave e kryeson Komisionin; Ministri i Tregtisë dhe Industrisë; ministri i ministrisë respektive që ka rolin udhëheqës politikbërës në sektorin ku operon NP-ja specifike; dhe dy ministri tjera që caktohen me vendim qeveritar.

Deri vonë, PTK-ja e ka pasur monopolin në shërbimet e telekomunikacionit në Kosovë. Në dhjetor të vitit 2007, Qeveria licencoi operatorin e dytë për telekomunikim, IPKO-në, ndërsa në vitin 2008 u licencuan edhe dy operatorë tjerë mobil. Tregu i energjetikës, në anën tjetër, është në gjendje të monopolit të natyrshëm. Sipas një punimi të hulumtimit të politikave R. Bradburd (Banka Botërore, 1992), nëse ndërmarrjet publike të monopolit të natyrshëm privatizohen në një mjedis ku nuk sigurohen të drejtat pronësore, menaxhimi i ri i ndërmarrjes me siguri do të ketë strategji jashtëzakonisht shkurtër pamëse të maksimizimit të profitit. Ka frikë që kjo gjendje mund të ndodhë edhe në Kosovë.

Tabela në vijim tregon disa indikatorë që duhet të testohen dhe zbatohen për politikën publike të çdo vendi, për të parë nëse është e mundur të dizajnohet procesi i privatizimit dhe të shmangen faktorët e pafavorshëm të jashtëm, dhe nëse mund të vendoset një kornizë efektive rregullative. Siç mund të shihet, vendimi për privatizimin e ndërmarrjes jokonkurrese në një vend me kapacitet të ulët për rregullimin e tregut, duhet të marrë parasysh hapat në vijim: 1. privatizimin e aranzhimeve menaxhuese, 2. instalimin e kornizës politike joshëse për treg, 3. instalimin e mjedisit të përshtatshëm ligjor, dhe në fund 4. shqyrtimin shitjes së ndërmarrjeve.

	Ndërmarrjet	Kushtet
Rrethanat e vendit	<i>Konkurrese</i>	<i>Jo-konkurrese</i>
Kapacitet të lartë rregullativ; joshës për tregun	Vendimi <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shitet</li> </ul>	Vendimi <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të sigurohet apo krijohet mjedisi i përshtatshëm ligjor</li> <li>• Pastaj të shqyrtohet shitja</li> </ul>
Kapacitet të ulët rregullativ; nuk është joshës për tregun	Vendimi <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shitet, duke u kujdesur për kushtet e konkurrencës</li> </ul>	Vendimi <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shqyrtohet privatizimi i aranzhimeve menaxhuese</li> <li>• Hartimi i kornizës politike joshëse për tregun</li> <li>• Krijimi i mjedisit adekuat</li> <li>• Pastaj të shqyrtohet shitja</li> </ul>

Burimi: Studim i Bankës Botërore nga S. Kikeri, J. Nellis dhe M. Shirley (1992)

Argumenti i Kikeri *et al.* për arritjen e mjedisit adekuat rregullativ para çdo shitjeje është plotësisht i pranueshëm. Konkurrenca e vazhdueshme dhe rregullimi i fuqisë së tregut janë fundamentale për realizimin e përfitimeve që premtohen me procesin e privatizimit.

### Bregat rreth privatizimit të NP-ve

Disa studime për privatizimin e ndërmarrjeve publike (për më tepër shih Megginson, 2005), operatorët e integruar vertikalisht, duhet të ndahen para se të vazhdohet me procesin e privatizimit, në mënyrë që të shmangët pronësia private e ndonjë monopoli të natyrshëm. Në rastin e tregut të energjetikës, ndarja e prodhimit të energjisë nga distribuimi duhet të bëhet paraprakisht në mënyrë që të zvogëlohet probabiliteti i subvencionimit të dyfishtë. Njëkohësisht me ndarjen e operatorëve të integruar vertikalisht, ekziston edhe nevoja për definimin e kornizës rregullative. Nëse ekziston një kornizë e tillë, atëherë privatizimi do të jetë shumë më i lehtë për qeveritë respektive

(Bortolotti et al., 1989), sepse mendohet që rregullimi e ul pasigurinë rreth procesit dhe rrjedhimisht edhe kostot e transaksionit.

Marrë parasysh që për privatizimin e NP-ve në Kosovë duhet të ketë konsensus bazik mbi principet kyçe, shumë analistë mendojnë që faktor kyq është përfshirja e shoqërisë civile dhe e grupeve tjera të interesit në diskutime dhe debate para fillimit të procesit, dhe gjatë fazës së zbatimit dhe monitorimit. Transparenca është një lloj e rëndësishme për ruajtjen e besimit të investitorëve (Saba, Privatizimi i Rrjeteve të Industrive, 1998). Në rastet kur ndërmarrjet janë monopole të natyrshme apo dominojnë në treg (siç është KEK-u në Kosovë), përveç nëse dizajnohen reforma për strukturë të tregut dhe programe rregullative të bazuara në incentiva, kur ndërmarrjet janë ende në duart e qeverisë, përfitimet e privatizimit me gjasë do të kapen plotësisht nga pronarët e rinj (Asher, 1999).

Siç u tha më lart, ekziston konsensus i gjerë për nevojën për reforma, ristrukturim dhe privatizim të NP-ve në mënyrë që ato të bëhen ekonomikisht më të qëndrueshme dhe joshëse për investitorët, por në anën tjetër, janë ngritur brenga legjitime nga shoqëria civile, mediat, sindikatat, dhe partitë politike, kryesisht për:

- **Kornizën aktuale ligjore:** çështja e privatizimit të Ndërmarrjeve Publike është e rregulluar pjesërisht nga dy nene të Ligjit për Ndërmarrje Publike, i cili konsiderohet bazë e dobët për sigurimin e procedurave, autorizimeve, llogaridhënies dhe transparencës së nevojshme;
- **Mungesën e politikave dhe strategjisë:** akoma nuk ekzistojnë politika se cilët modele dhe forma të privatizimit do të përdoren, përderisa rajoni ka përvojë mjaft të madhe e cila mund të shfrytëzohet për ndërtimin e procesit të qëndrueshëm të privatizimit të NP-ve për të mirën e shoqërisë kosovare;
- **Mungesën e transparencës:** qeveria nuk e ka informuar opinionin e gjerë për politikën e saj për këtë proces dhe poashtu ka mungesë të debatit publik për kostot dhe përfitimet e këtij procesi, për mundësitë alternative të privatizimit dhe për zgjidhjet më të mira në rrethanat aktuale.

Qeveria do ta zvogëlonte rrezikun e gabimeve në qoftë se i merr parasysh këto çështje dhe nëse harton politika të qarta. Ç'është më e rëndësishme, qeveria duhet ta ul pasigurinë rreth procesit dhe kostove të transaksionit.

## **Konkludime dhe Rekomandime**

Në procesin e hartimit të politikave dhe rregulloreve për procesin e privatizimit të NP-ve, Qeveria e Kosovës duhet t'i marrë parasysh, në mes tjerash, çështjet në vijim:

1. Hartimi i strategjisë së qartë e cila i merr parasysh pasojat sociale, ndikimin në aspektin e papunësisë dhe mjedisit (posaçërisht në rastin e KEK-ut), dhe që do t'i adresojë faktorët kontraktual dhe kulturor.
2. Në rastin e KEK-ut, Departamenti i Distribuimit duhet të privatizohet i pari. Ndërtimi i kapaciteteve në mekanizmat rregullativ është tejet i rëndësishëm, në



- mënyrë që të përgatiten ato për reformat në industrinë e infrastrukturës dhe në njohjen e ndërmarrjeve me ligje normale komerciale dhe atyre të konkurrencës.
3. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës duhet të privatizohet me marrëveshje të koncesionit deri në 20 vite, sipas modelit Ndërto – Opero – Transfero.
  4. Minierat e qymyrit poashtu duhet të privatizohen me marrëveshje të koncesionit deri në 20 vite.
  5. Pjesëmarrja në forumet rregullative rajonale dhe ndërkombëtare në mënyrë që rregullatorët të njihen me përvojën e homologëve të tyre dhe të ndihmohen në zhvillimin e bashkëpunimit për çështje rajonale dhe për zhvillimin e lidhjeve me përfaqësues të bizneseve dhe organizata të konsumatorëve.

*Burimet:*

Instituti Riinvest, "Qeverisja e Korporatave në Ndërmarrjet Publike", nëntor 2006  
Privatizimi dhe Post-Privatizimi në Kosovë: Gota gjysmë e zbrazët apo gjysmë e mbushur? – Raport Hulumtues, Instituti Riinvest (Forumi 2015), 2008

### ***3.2 Zbatimi i CEFTA-së: Realitet apo vetëm dëshirë e bukur?***

*Autore: Mimoza Kusari – Lila, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë*

#### **Hyrje**

Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore fillimisht u iniciua për të krijuar një bashkim tregtar në mes të vendeve nënshkruese shumica e të cilave sot janë vende anëtare të Bashkimit Europian. Marrëveshja e njëjtë u zbatua për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Moldavinë dhe u finalizua në vitin 2007 kur marrëveshja u ratifikua nga parlamentet e të gjitha vendeve përveç Kosovës, e cila ishte nën udhëheqjen e Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK 1244) dhe PSSP-ja e ratifikoi marrëveshjen.

Tregtia e lirë dhe bashkimi doganor janë ideja bazike për ndërtimin e BE-së. Prandaj, nënkuptohet që tregtia e lirë është kyçe për stabilitetin dhe normalizimin e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, ekziston tendenca për të dëshmuar që Ballkani Perëndimor ka stabilitet të plotë politik, derisa në të njëjtën kohë injorohen disa çështje dhe probleme reale që dalin nga zbatimi i CEFTA-së dhe i marrëveshjeve tjera rajonale, të cilat shpeshherë dëshmojnë mungesën e vullnetit politik nga ana e vendeve nënshkruese për zbatimin e marrëveshjes.

Shumica e të hyrave në ekonominë kosovare burojnë nga tregtia, duke e bërë Kosovën klient serioz të vendeve fqinje, por ajo nuk mund të konkurrojë apo veprojë në nivelin e njëjtë të kapaciteteve me vendet fqinje apo me anëtarët tjerë të CEFTA-së. Problemet që burojnë nga kjo janë të dyfishta:

1. Mungesa e kapacitetit për të garuar me industrinë e qëndrueshme të vendeve tjera.
2. Çështjet politike që burojnë nga shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe pranimi i realitetit të ri nga shumica e vendeve anëtare të CEFTA-së.

Zgjidhja e këtyre çështjeve kërkon më tepër se vetëm mbledhje formale të organizuara nga sekretariati i CEFTA-së në komisione dhe nën-komisione. Zgjidhja kërkon përfshirjen e madhe politike dhe angazhimin e të gjitha vendeve nënshkruese të marrëveshjes.

#### **Bashkëpunimi rajonal në terren**

Konflikti i heshtur apo beteja politike në mes Kosovës dhe Serbisë paraqet me gjasë pengesën më të vështirë për zhvillim të bashkëpunimit rajonal. megjithatë, nuk mund ta neglizhojmë faktin që Bosnja dhe Hercegovina dhe Moldavia nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe nuk mund të parashohim nëse ato do ta njohin në të ardhmen e

afërt, gjë që do ta lehtësonte edhe bashkëpunimin ekonomik. Për më tepër, fakti që Kosova e ka nënshkruar marrëveshjen CEFTA nëpërmjet UNMIK-ut, ofron bazë ligjore për vendet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe që akoma refuzojnë dërgesat nga Kosova që kalojnë nëpër kufijtë e tyre me argumentin se vula e re e Kosovës nuk është ajo që ishte konfirmuar fillimisht kur u nënshkrua marrëveshja. Probleme të kësaj natyre janë raportuar në Mal të Zi, vend ky i cili ka udhëhequr sekretariatit e CEFTA-së në vitin 2009. Problemi do të rritet dhe do të bëhet edhe më serioz kur Serbia ta marrë përsipër rolin udhëheqës (kryesimin) në sekretariatit e CEFTA-së. Problemet rreth zbatimit të kësaj marrëveshjeje nuk kanë filluar vetëm pas shpalljes së pavarësisë dhe problemet e para u vërejtën qysh në fillim të hyrjes në fuqi të marrëveshjes në vitin 2006.

Problem madhor ishte marrëveshja bilaterale dhe më vonë multilaterale me Bosnjën dhe Hercegovinën. Marrëveshja u nënshkrua në vitin 2006 kur Bosnja nuk i njihte dokumentet e udhëtimit të UNMIK-ut dhe tabelat e regjistrimit të Kosovës (nën UNMIK 1244). Kjo marrëveshje automatikisht ka krijuar disavantazhe dhe mungesë të ekuilibrit në mes bizneseve nga Kosova dhe atyre nga Bosnja. Përveç kësaj, doganat maqedonase filluan të zbatojnë masa restriktive (barriera jotarifore) për prodhuesit e mëdhenjë të miellit nga Kosova. Nën ndikimin e lobit të miellit dhe faktorëve të tjerë politikë, autoritetet maqedonase i bllokuan për më tepër se gjashtë javë kamionët nga Kosova me arsyetimin se doganat maqedonase duhet të verifikojnë nëse origjina e produktit është në pajtim me rregullat e CEFTA-së. Çështja u raportua në Komisionin Europian dhe në sekretariatit e CEFTA-së dhe u desh të mbahen dy takime përfshirë aty Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe angazhimin e faktorit politik ndërkombëtar dhe vendor për t'i nisur diskutimet.

Shtrohet pyetja: nëse marrëveshja e tregtisë së lirë kalon nëpër vështirësi të kësaj natyre, si do t'i respektojnë vendet atëherë marrëveshjet bilaterale të cilat nuk monitorohen apo mbikëqyren nga mekanizmat ndërkombëtar. Për ta mbështetur këtë deklaratë, ka pasur probleme të herëpashershme (duke marrë parasysh që Kosova nuk është eksportuese e madhe apo serioze, €6 milion për vitin 2008 krahasuar me €1.8 miliard import), që mjaftuan për dekurajimin e prodhuesve vendor, dhe poashtu t'iu ofroj dëshmi fqinjëve tanë që institucionet kosovare kurrë nuk do të aplikojnë masa të reciprocitetit dhe doganat kosovare, duke mos qenë nën instruksionet e ndonjë autoriteti mbikëqyrës, do të vazhdojnë ta zbatojnë marrëveshjen sipas ligjit. Kjo gjendje nuk vërehet te vendet e tjera që janë nënshkruese të marrëveshjes për tregti të lirë.

Vendet po eksplorojnë fusha të ndryshme për ta mbrojtur tregun dhe produktet e tyre. Gjatë Majit të vitit 2009, parlamenti boshnjak ka kaluar leximin e parë të draft ligjit që i mbron dhe jep përparësi produkteve bujqësore nga Bosnja. Veprimet e autoriteteve boshnjake shkaktuan reagime serioze nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare, përfshirë Parlamentin Evropian dhe nga udhëheqësit e shteteve, siç është rasti i Kroacisë sepse ajo është net eksportuese në Bosnje. Çështja akoma mbetet e hapur.

Ka pasur edhe konteste tjera në mes vendeve nënshkruese të marrëveshjes përfshirë këtu Maqedoninë dhe Kroacinë, Shqipërinë dhe Maqedoninë, konteste të cilat u zgjidhën nëpërmjet masave të reciprocitetit. Kosova duket se është vendi i vetëm nënshkrues i cili

nuk ka reagu në mënyrën e njejtë si partnerët e tjerë tregtar. Përveç kësaj, Kosova është partneri i vetëm në marrëveshje që nuk ka negociuar asnjë nen të marrëveshjes dhe nuk ka vënë asnjë kusht për zbatimin e marrëveshjes.

Vendet e Ballkanit Perëndimor në përgjithësi kanë vështirësi në zbatimin e plotë të marrëveshjeve tregtare, prandaj duhet cekur që me siguri do të kalojnë disa vite para se të shohim zbatimin e plotë (pa ndërhyrje politike) të këtyre marrëveshjeve. Njëri prej faktorëve kyç në këtë proces është edhe qëndrimi dhe ndërmjetësimi i Komisionit Europian në këto marrëveshje dhe faktori i kushtëzimit që ai paraqet për vendet që i shkelin marrëveshjet rajonale.

### **Pse nuk funksionojnë marrëveshjet e tregtisë**

Të gjitha vendet nënshkruese të CEFTA-së janë ekonomi në tranzicion, burojnë nga një treg ekonomik mjaft i centralizuar, dhe synojnë të futen në ekonominë e hapur të tregut, proces ky i cili do të marr kohë derisa vendet dhe administratat e tyre të kenë besim të plotë dhe të punojnë për të mirën e këtyre marrëveshjeve. Legjislacioni në Kosovë është në pajtim të plotë me BE-në, por problemet shfaqen në zbatimin e këtij legjislacioni dhe në funksionimin e sundimit të ligjit. Shpeshherë, shërbyesit civil, të cilët kanë rol kyç në administratë, nuk i kuptojnë qartë objektivat që duhet t'i zbatojnë. Në situatë të ngjashme janë edhe vendet që e kanë vështirë t'i tejkalojnë paragjykimet politike që ndërliken me çështjet brenda sistemit të tyre.

Përveç çështjeve politike, edhe kriza globale financiare e ka rritur dëshirën e vendeve që të mendojnë për masa mbrojtëse për tregjet dhe produktet e tyre. Kjo situatë e re e ka ulur fuqinë globale blerëse dhe rrjedhimisht e ka ulur edhe shkallën e ekonomisë lokale, përfshirë këtu edhe Ballkanin Perëndimor. Për t'i mbrojtur ato që kanë mbetur, qeveritë po mundohen të prioritojnë, të rregullojnë tregjet e tyre sipas përparësive të produkteve të tyre, pa marrë parasysh përkushtimin e marrë në marrëveshjet multilaterale të tregtisë. Vendet e zhvilluara nuk paraqesin përjashtim në këtë rast, prandaj është vështirë të kritikohen vetëm vendet në zhvillim e sipër.

Siç u tha më lart, kjo krizë e ka prekur BE-në si dhe pjesën tjetër të botës. Prandaj menaxhimi i problemeve që burojnë nga marrëveshja për tregti në Ballkanin Perëndimor do të kërkojë angazhim të shprehur politik nga vendet anëtare të cilat njëkohësisht po mundohen ta zgjidhin krizën ekonomike e cila i ka prekur vendet e tyre si dhe Bashkimin Europian në tërësi. Prandaj, zgjidhja qëndron në ndryshimin e perceptimit dhe vendimin që qeveritë e vendeve nënshkruese të punojnë për funksionimin e marrëveshjes së tregtisë. Qytetarët e vendeve nënshkruese do të përfitojnë më së shumti nga këto marrëveshje dhe qeveritë duhet të bëjnë plane dhe përgatitje për tejkalimin e pengesave.

Çështja më kritike e cila mbetet të zgjidhet është normalizimi i marrëdhënieve diplomatike në mes të Kosovës dhe Serbisë. Nëpërmjet masave të reciprocitetit, autoritetet serbe mund të fillojnë të sillen ndryshe me produktet kosovare të cilat kalojnë tranzit nëpër Serbi në rrugën e tyre drejt vendeve europiane, duke e ditur që nëse Kosova fillon të zbatoj masat e reciprocitetit atëherë vëllimi tregtar prej 300 milion eurosh është

në pyetje. Pas Maqedonisë, Serbia është partneri i dytë tregtar i Kosovës. Importet nga Serbia janë kryesisht produktet ushqimore, pijet dhe cigaret (30.7% e importit total nga ky vend).

### **Zhvillimet e mundshme për CEFTA-në**

Meqë situata e lartpërmendur nuk është e qëndrueshme, në këtë punim kam paraqitur pesë skenarë të mundshëm në lidhje me të ardhmen e CEFTA-së:

*Skenari i Parë: Vazhdimi i Status Kuos*

Përparësitë: Deficiti jotregtar është aq i lartë dhe ka aq shumë çështje që ndërlidhen me këtë saqë gjasat për ta ndryshuar këtë gjendje pa ndërmarrë ndonjë veprim janë minimale apo nuk ekzistojnë fare.

*Skenari i Dytë:*

Kosova fillon zbatimin e masave të reciprocitetit menjëherë pasi produktet kosovare bllokohen nga shërbimet doganore të ndonjërit prej vendeve fqinje, dhe doganat kosovare fillojnë të zbatojnë masat e njëjta ndaj produkteve të vendit në fjalë.

Përveç kësaj, Ministria e Punëve të Jashtme i dërgon një shkresë vendeve respektive mbi problemin e identifikuar. Në lidhje me shkresën: Ministria e Punëve të Jashtme duhet të rekrutojë zyrtarë komercial për ambasadat kosovare të cilët do të merren me çështjet komerciale në vendet ku ata shërbejnë. Nëse MPJ-ja nuk ka buxhet apo nëse procesi i rekrutimit zgjatet shumë, duhet të emërohet një përfaqësues alternativ për t'u marrë me masat komerciale.

*Anët pozitive:*

- Dëshmon sovranitetin dhe funksionalitetin e shtetit;
- Fiton vëmendjen e vendeve të CEFTA-së të cilat do të veprojnë me kujdes më të madh para se të zbatojnë barriera jotarifore të tregtisë;
- Do ta rris buxhetin (doganat e Kosovës zbatojnë tarifa doganore për mallrat të cilat përndryshe nuk duhet të paguajnë doganën dhe kështu do të rritet Buxheti i Konsoliduar i Kosovës);
- Ofron mundësi për prodhuesit vendor (duke e bërë më të vështirë dhe më shtrenjtë për produktet e huaja që të futen në tregun kosovar, dhe prodhuesit vendor do të kenë mundësi të arrijnë deri tek konsumatorët vendor).

*Anët negative:*

- I dëmton importuesit dhe ata që ndërlidhen me importin
- Do të rris kontrabandën derisa disa tregtarë do të përpiqen t'i shmangen tarifave doganore

## Skenari i Tretë: Kosova tërhiqet nga CEFTA

### Anët pozitive:

- Ofron hapësirë të tregut për prodhuesit vendor
- Pakënaqësia me procesin shfaqet në mënyrë të hapur
- Mundëson një marrëveshje të re me rregulla dhe rregullore të reja

### Anët negative:

- Kosova do të shihet si vend i izoluar
- Rrezikon procesin e integrimit
- Ofron hapësirë dhe perceptim për treg të kontrolluar dhe
- Në aspektin politik prezanton vështirësi serioze për rifillimin e negociatave (duke marrë parasysh që pesë vende anëtare të BE-së nuk e kanë njohur Kosovën)

Skenari i Katërt – BE-ja (Komisioni Europian) do të luaj rol më aktiv në rajon.

Negociatat për statusin e vendit kandidat mund të krijojnë presion për të gjitha vendet e mundshme candidate.

Skenari i Pestë – ndryshimi i marrëveshjes CEFTA në mënyrë që ajo të bëhet më funksionale. Marrëveshja ndryshohet në bazë të ndryshimeve politike dhe funksionale që kanë ndodhur në rajon. Përveç kësaj, një mekanizëm mbikëqyrës i Komisionit Europian duhet të jetë më aktiv kur lindin probleme.

Nga pesë skenarët e mundshëm, skenari i dytë dhe i pestë kanë gjasa të ofrojnë rezultate më konkrete drejt përbushjes së objektivave të CEFTA-së.

## **Konkludim dhe Rekomandime**

Marrëveshja e CEFTA-së është padyshim mekanizëm tejet i rëndësishëm për integrimin e Ballkanit Perëndimor dhe për normalizimin e marrëdhënieve në mes vendeve anëtare të BE-së. Megjithatë, duke marrë parasysh ndryshimet dramatike në realitetin në terren, shpalljen e pavarësisë së Kosovës, krizën globale financiare, ndryshimet në statusin e vendeve nënshkruese të cilat po lëvizin drejt anëtarësimit në BE pa e marrë parasysh shkeljen e CEFTA-së (siç është rasti i Serbisë dhe i Maqedonisë), ka ardhur koha që të shikohen mundësitë e modifikimit apo ndryshimit eventual të marrëveshjes.

Qartazi, vet marrëveshja nuk i ka shërbyer synimit të saj në Kosovë, duke dështuar të përbush tri objektivat për të cilat CEFTA është dizajnuar: stabilizimi i marrëdhënieve me vendet fqinje, përmirësimi i klimës për investime dhe rritja e eksportit. Asnjëri prej këtyre nuk është aktual në rastin e Kosovës.

Në mënyrë që Kosova ta përmirësoj pozitën e vet në raport me vendet fqinje, Qeveria e Kosovës duhet ta trajtojë këtë çështje me seriozitet dhe të punojë në dy aspekte:

- Të zhvillojë qasje të orientuar kah eksporti duke zbatuar standarde të cilësisë dhe t'i ofrojë asistencë kompanive prodhuese (qoftë ligjore apo infrastrukurore) dhe
- Të jetë më aktive në marrëdhëniet e jashtme duke e vendosur tregtinë si njëri prej objektivave të politikës së jashtme. Qeveria duhet të angazohet më tepër në rritjen e kapaciteteve të Ambasadave për t'u marrë me shkëmbimet tregtare apo me probleme tjera që ndërlidhen me këtë dhe të reagojnë nëse vendet e tjera bëjnë shkelje serioze.

### ***3.3 Si të rritet Kapaciteti i Kosovës për Eksport***

*Auror:* Flamur Keqa, Oda Ekonomike e Kosovës (OEK)

#### **Hyrje**

Në periudhën e pasluftës, ekonomia kosovare është ballafaquar me probleme të shumta strukturore dhe nuk ka arritur ta rikthejë fuqinë e dikurshme të para viteve 1990. Niveli i prodhimit lokal është ende i ulët dhe produktet kosovare akoma nuk kanë arritur standard cilësor me të cilin do të mund të garonin në tregjet tjera të rajonit, e mos të flasim fare për tregjet europiane. Kapitali i huaj po depërton shumë ngadalë dhe përqendrohet kryesisht në sektorin bankar dhe në sektorin e telekomunikimit. Përkrahja institucionale për bizneset në Kosovë është pothuajse inekzistente dhe nuk ka fare përkrahje apo lehtësime për punën e ndërmarrjeve afariste që kanë potencial për eksport. Përveç mungesës së përkrahjes institucionale, edhe përkrahja e shoqatave të bizneseve për bizneset që kanë operuar në treg ka qenë e kufizuar. Sektori i biznesit besohet të jetë hallka më e dobët e ekonomisë kosovare dhe qeveria duhet të ofroj përkrahje më të madhe në mënyrë që ky sektor të funksionoj më mirë.

Rritja e prodhimit dhe me këtë edhe rritja e kapacitetit eksportues të bizneseve mund ta përshejtojnë kapacitetin integruar të Kosovës në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Në njërin anë, do të rritej vetëqëndrueshmëria sepse do të shtohet kërkesa lokale për produkte bazike dhe me këtë do të ulej varësia nga produktet e importuara. Në të njëjtën kohë, do të rritej kapaciteti konkurrues i produkteve kosovare në tregjet e huaja.

Kjo tregon qartë që çështja e eksportit duhet të trajtohet në mënyrë komplekse dhe përmbytësore, me përfshirjen e pashmangshme të të gjitha grupeve të interesit, ku strategjia dhe vizioni i institucioneve qeveritare është poashtu tejet i rëndësishëm. Në këtë drejtim, barra më e madhe bie mbi supet e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Agjencionit Kosovar për Promovim të Investimeve (AKPI).

#### **Problemet strukturore të ekonomisë kosovare**

Në fund të viteve 1980, ekonomia kosovare, edhe pse më pak e zhvilluar se njësitë tjera federale të ish-Jugosllavisë, kishte strukturë më të favorshme ekonomike se sot. Ekonomia kosovare përbëhej nga ndërmarrjet e vogla, si dhe nga prodhuesit e mesëm dhe të mëdhenjë produktet e të cilëve shiteshin jo vetëm në pjesët tjera të ish-Jugosllavisë por edhe në vendet e huaja, madje edhe në tregjet e Europës Perëndimore.

Në fund të viteve 1980 dhe para shpërbërjes së Jugosllavisë, ekonomia kosovare mbështetej në numër të madh të ndërmarrjeve që prodhonin produkte gjysmë të përfunduara dhe të përfunduara. Në vitin 1987, industria dhe minierat përbënin 47.5% të produktit vendor në Kosovë, peshkataria dhe bujqësia përbënin 20.8%, tregtia 12%, ndërtimtaria 6.8%, dhe infrastruktura e transportit dhe komunikimit 4.5%.



Në vitin 1987, produktet e përpunuara të thjeshta dhe të larta përbënin 95% të produkteve kosovare për eksport. Industria dhe minierat përbënin deri në 98.53% të eksportit total. Megjithatë, Kosova përbënte vetëm 1.4% të importit dhe eksportit në balancin e përgjithshëm tregtar të ish-Jugosllavisë. Prandaj, në krahasim me republikat tjera të ish-Jugosllavisë, lirisht mund të themi që Kosova ende po vuan pasojat negative të recesionit ekonomik në aspekt të tregtisë së jashtme posaçërisht eksportit.

Pas shkatërrimit të vazhdueshëm të ekonomisë gjatë viteve të 1990-ta dhe luftës së vitit 1999, prodhimtaria në Kosovë ishte pothuajse inekzistente dhe tregu tradicional i jashtëm për eksport kishte humbur. Shumica e kapaciteteve prodhuese me potencial eksportues ishin shkatërruar, dhe ndërkohë akoma nuk janë zhvilluar kapacitetet e reja me potencial të ri eksportues.

Në gjendjen aktuale dhe në mungesë të balancit në strukturën ekonomike, sektori i eksportit mbetet njëri prej sektorëve më të dobët dhe më së paku të mbrojtur. Derisa vendet e tjera të rajonit përdorin masa të ndryshme për stimulimin apo subvencionimin e prodhimit dhe eksportit të produkteve të tyre, ekonomia kosovare nuk është në nivelin e nejtë në këtë drejtim.

Stagnimi prej më se 15 viteve në Kosovë ka pasur ndikim negativ në konkurrencën e produkteve në krahasim me produktet e vendeve të rajonit dhe më tej. Derisa sasia e importeve e mbuluar nga eksportet kosovare për vitin 2007 ishte 7%, në vitin 2008 kjo shifër arriti 10%. Gjatë viti 2008, Kosova importoi produkte në vlerë prej €1.83 miliard, derisa mallrat e eksportuara arrinin vlerën prej vetëm €84 milion. Deficiti tregtar i Kosovës në vitin 2008 arriti shumën prej €1.65 miliard, apo rreth 60% të GDP-së. Një element i rëndësishëm që mund të jetë përcaktues për këtë gjendje është cilësia e produkteve vendore apo niveli i tyre konkurrues.

Shumica e eksporteve, 44.3% (në vitin 2007 – 42%), përbëhej nga metalet dhe pjesët metalike në vlerë prej €39.3 milion. Produktet e eksportuara minerale përbënin 10.9% të mallrave totale të eksportuara përcjell nga produktet ushqimore (9.95%) dhe produktet e perimeve (9.2%). Sa i përket tregjeve, shumica e eksporteve i kishin destinim vendet nënshkruese të Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropës Qendrore (CEFTA) në vitin 2008 me 42.7% të vëllimit total (në vitin 2007 - 49%) derisa eksportet në vendet e BE-së përbënin 33.5% të eksportit të përgjithshëm. Në vitet e para pas luftës, eksporti kryesor ishin hekurishtet, por me kalimin e viteve kemi parë zhvillime në sektorin e prodhimit dhe përpunimit e sidomos në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë, etj., dhe kështu edhe këta sektorë ekonomik kanë filluar t'i eksportojnë produktet e tyre.

Rol të rëndësishëm në zhvillimin e sektorëve të caktuar të prodhimit dhe rrjedhimisht edhe eksporteve, kanë luajtur donacionet nga zyrat e USAID-it, GTZ-së, SDC-së, ADA dhe të tjerëve. Këto agjenci i kanë përkrahur sektorët industrial siç janë ushqimi, metali, industrinë e drurit dhe zhvillimin rural në forma të ndryshme. Kosova nuk aplikon TVSH-në e as detyrime doganore për produktet e eksportit. Për më tepër, Kosova nuk aplikon kuota për eksportet dhe importet.

Kosova është anëtare e CEFTA-së, e cila përfshin 8 shtete, 7 vende të Ballkanit Perëndimor përfshirë edhe Moldavinë. CEFTA përfaqëson një treg prej rreth 28 milion konsumatorë. Megjithatë, në këtë drejtim Kosova po ballafaqohet me vështirësi të ndryshme nga vendet fqinje siç janë Serbia dhe Bosnja e Hercegovina.

Problemet më të ndjeshme në Kosovë që ndikojnë negativisht në sektorin e eksporteve janë:

1. Mungesa e kapitalit dhe çmimet e larta
2. Mungesa e prodhuesve me përvojë në fushën e eksportit
3. Mungesa e certifikatave të standardeve dhe cilësisë (mallrat e importuara i nënshtrohen kontrollit të pakët të cilësisë në krahasim me produktet vendore që eksportohen dhe të cilat i nënshtrohen kontrollit të rreptë)
4. Marketingu dhe promovimi i dobët
5. Roli i vogël i institucioneve qeveritare në përkrahje të eksporteve dhe krijimit të mjedisit më të mirë për rritjen e aftësive të tyre konkurruese.

### **Nevoja për përmirësimin e politikave tregtare**

Aktualisht struktura e ekonomisë kosovare nuk është e favorshme. Deficiti tregtar është tejet i lartë. Institucionet akoma nuk i kanë përqendruar përpjekjet e tyre në sektorin e eksportit dhe për zvogëlimin e deficitit tregtar.

Sektorët me potencial eksportues në Kosovë besohet të jenë: minierat dhe energjia, bujqësia dhe një gamë e gjerë e mallrave që konsumohen. Këta sektorë mund të japin kontribut pozitiv në përmirësimin e balancit tregtar deri në ristrukturimin ekonomik të Kosovës gjë e cila shihet si qëllim afatgjatë.

Sipas Politikave Tregtare të Kosovës, të miratuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet sektorit të eksportit. Megjithatë, ekziston rreziku që këto politika nuk do të zbatohen sipas legjislacionit të ri dhe në mënyrë efikase.

Meqë prodhuesit vendor akoma nuk i përmbushin standardet e cilësisë së lartë, ata kanë më tepër gjasa të depërtojnë në tregje të rajonit të cilat kanë standarde më pak strikte. Megjithatë, duhet të synohet përmirësimi gradual i standardeve të prodhimit dhe marketingut në mënyrë që depërtohet edhe më tutje në fushën e eksportit. Kjo do të thotë që promovimi i eksporteve në tregjet rajonale duhet të jetë qëllim afatshkurtër i politikave tregtare ndërsa promovimi i eksporteve në Bashkimin Europian do të ishte qëllim afatmesëm. Megjithatë, duhet të vazhdohet dhe të zhvillohet edhe më tutje stimulimi i aktiviteteve (nëpërmjet mjeteve adekuate politike) për eksport në tregjet rajonale dhe në BE. Produktet kosovare mund të eksportohen në BE sipas termeve të privileguara dhe janë shumë të favorizuara në SHBA.

Edhe Ligji nr. 2002/6 mbi aktivitetet e tregtisë së jashtme, i datës 8 Maj 2003, e rregullon eksportin. Ky ligj përmban rregulla bazike për, në mes tjerash, eksportin e mallrave, standardeve dhe kërkesave teknike për mallrat e eksportuara, licencat e eksportit dhe

eksportet e ndaluara. Në ligj thuhet që produktet specifike duhet të kenë certifikata specifike siç janë standardet teknike, sanitare, fito-sanitare dhe bazike të produkteve. Për eksportimin e mallrave nga Kosova nuk nevojitet leja apo autorizimi nga autoritetet publike përveç për produktet që gjenden në listën e eksporteve.

## **Konkludime dhe Rekomandime**

*Në vijim është përmbledhja e gjendjes aktuale të eksportit:*

1. Përkrahja e mangët institucionale për prodhuesit dhe eksportuesit
2. Cilësia e ulët e produkteve e shoqëruar me kosto të larta të prodhimit
3. Niveli i ulët i eksportit në krahasim me qarkullimin tregtar, pjesëmarrja e ulët e eksportuesve në tregjet e huaja
4. Vështirësitë në përmirësimin e konkurrencës së prodhimtarisë vendore sa i përket tregjeve rajonale dhe tregjeve të huaja
5. Ndikimi negativ në faktorët makroekonomik

*Si hapa fillestar për përmirësimin e eksportit ne propozojmë:*

- Hartimin e programeve për promovimin e eksportit, për të qenë më specifik, rekomandohet që Qeveria dhe Agjencioni për Promovimin e Investimeve në Kosovë të krijojnë:
- Bazë të dhënave për eksportuesit potencial dhe partnerët e huaj

Kjo bazë e të dhënave do të shërbente si mjet i informimit për prodhuesit dhe eksportuesit vendor rreth tregjeve të huaja, për mundësitë e bashkëpunimit me partnerë të huaj dhe për mundësinë e zhvillimit të marketingut ndërkombëtar.

- Për eksportuesit lokal, duhet të jetë e rëndësishme të prodhojnë produkte me vlerë të shtuar, t'i rrisin aftësitë e konkurrencës dhe ato profesionale, dhe ta rrisin nivelin e komunikimit me partnerët e huaj.
- Integrimi rajonal dhe eksportet do të çojnë në përmirësim të nivelit të cilësisë të produkteve vendore. Janë bërë disa ndërhyrje në disa produkte specifike dhe kjo ka sjell rezultate. Ky zhvillim inicial pozitiv është indikacion që ka potencial për progres në sektorin e eksportit. Prandaj, përkundër vështirësive dhe barrierave të ndryshme, bizneset duhet të kenë vetëbesim që ekzistojnë gjasat për të depërtuar në tregun e eksporteve.